

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Lëvizja FOL,
Instituti për Studime të Avancuara GAP, Klubi për Politikë të
Jashtme (KPJ), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe
Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL)

RAPORTI I PROGRESIT

Made in Kosova

Tetor 2010, Prishtinë



RAPORTI I PROGRESIT
Made in Kosova

PËRMBAJTJE

Shkurtesat dhe akronimet	3
Hyrje.....	4
Shoqëria civile dhe matja e progresit	4
1. MARRËDHËNIET KOSOVË - BE	6
1.1. Kosova në raport me integrimin evropian.....	6
1.2. Roli i EULEX-it	7
2. PROGRESI POLITIK DHE INSTITUCIONAL	10
2.1. Kuvendi	10
2.2. Qeveria	12
2.3. Administrata publike	12
2.4. Menaxhimi i zgjedhjeve	13
2.5. Sundimi i ligjit dhe sistemi i drejtësisë.....	15
2.6. Lufta kundër korrupsionit	19
2.7. Politika e jashtme dhe shërbimi diplomatik	21
3. PROGRESI EKONOMIK	23
3.1. Politikat ekonomike dhe stabiliteti makroekonomik	23
3.2. Tregtia e jashtme.....	24
3.3. Zhvillimi i sektorit financiar	27
3.4. Hyrjet dhe daljet në treg të ndërmarrjeve	28
4. STANDARDET EVROPIANE.....	30
4.1. Prokurimi publik	30
4.2. Punësimi dhe politikat sociale	31
5. POLITIKAT SEKTORALE	34
5.1. Shoqëria civile dhe Media	34
5.2. Sektori i sigurisë	35
5.3. Liberalizimi i vizave.....	36
Për Organizatat	39

Shkurtesat dhe akronimet

AKI	Agjensioni Kosovar për Inteligjencë	KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
AKK	Agjensioni Kundër Korrupsionit	KSK	Këshilli i Sigurisë së Kosovës
APP	Agjensioni i Prokurimit Publik	KZAP	Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ARC	Agjensioni i Regjistrimit Civil	MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës	MMK	Monitorim, Mentorim dhe Këshillim
BE	Bashkimi Evropian	MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
BPV	Bruto Produkti VENDOR	MSH	Ministria e Shëndetësisë
BQK	Banka Qendrore e Kosovës	MTPT	Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit
CEFTA	Central Europea Free Trade Agreement	NDI	National Democratic Institute
DK	Dogana e Kosovës	OJQ	Organizatë Joqeveritare
DV	Demokracia në Veprim	OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
EBU	European Broadcasting Union	OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
ENEMO	European Network of Election Monitoring Organizations	OSHP	Organi Shqytrues i Prokurimit Publik
EULEX	European Union Rule of Law Mission	PACE	Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar	PK	Policia e Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë e Kosovës	QNR	QendrA e Numërimit të Rezultateve
FSKP	Fondi Slloven-Kosovar i Pensioneve	RTK	Radio dhe Televizioni i Kosovës
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë	SHIK	Shërbimi Informativ i Kosovës
IBM	Integrated Border Management	TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
ICO	International Civilian Office	UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
IHD	Investimet e Huaja Direkte	UNMIK	United Nations Mission in Kosova
IPOL	Instituti Ballkanik i Politikave IPOL		
IPVQ	Institucionet e Përkohëshme të Vetëqeverisjes		
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve		
KE	Komisioni Evropian		
KES	Këshilli Ekonomiko-Social		
KFOR	Kosova Forces		
KIPRED	Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave		
KPM	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës		
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve		

Hyrje

Në pritje të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, disa organizata të shoqërisë civile e kanë përgatitur versionin kosovar të këtij raporti, i cili e reflekton vlerësimin dhe pikëpamjen vendore mbi progresin në Kosovë. Ky raport vlerëson periudhën Tetor 2009 - Tetor 2010 dhe mbulon këto fusha:

- marrëdhëniet Kosovë - BE (integrimi evropian, roli i EULEX),
- progresi politik dhe institucional (konsolidimi i institucioneve, zgjedhjet, sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit, politika e jashtme),
- progresi ekonomik (politikat ekonomike, tregtia e jashtme, sektori financiar),
- standardet evropiane (prokurimi publik, punësimi, politikat sociale) dhe
- politikat sektorale (shoqëria civile, media, siguria, liberalizimi i vizave)

Secila pjesë e raportit është vlerësuar në dimensionet e legjislationit, funksionalitetit të përgjithshëm në sektor, duke ofruar edhe rekomandime për përmirësimin e gjendjes. Pasi që organizatat që kanë hartuar këtë raport janë të specializuara në fushat që i kanë mbuluar, një pjesë e materialit hulumtues reflekton punën monitoruese, hulumtuese, analitike dhe raportuese të tyre gjatë periudhës një-vjeçare. Për më tepër, vlerësimi mbështetet në shumë burime primare e sekondare dhe në konsultimet e zhvilluara me ekspertë të fushave respektive.

Qëllimi i këtij produkti, i cili është unik për shtetet që e marrin Raportin e Progresit nga Komisioni Evropian, është të ofrojë një pasqyrë alternative ndaj progresit (ku hyjnë edhe stagnimi dhe regresi) në Kosovë, duke reflektuar pikëpamjen dhe vlerësimin e organizatave të shoqërisë civile kosovare mbi fushat esenciale të qeverisjes shtetërore.

Organizatave që e kanë përpiluar Raportin e Progresit *Made in Kosova* janë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Lëvizja FOL, Instituti për Studime të Avancuara GAP, Klubi për Politikë të Jashtme (KPJ), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Instituti Ballkanik i Politikave (IPOL).

Shoqëria civile dhe matja e progresit

Në të gjitha shtetet aspiruese të Bashkimit Evropian, vlerësimi i progresit të përgjithshëm shtetëror është fushë ekskluzive e Komisionit Evropian, i cili përmes instrumentit të Raportit të Progresit jep mendimin e vet për zhvillimet një-vjeçare në këto shtete. Vlera e një instrumenti të këtillë është konstatuar të jetë e madhe, ndërsa efektet janë ndier drejtpërdrejtë në përmirësimin e performansës në sektorët më të kritikuar të qeverisjes shtetërore. Një nga dimensionet më të diskutuara të Raportit të Progresit të KE-së gjatë viteve të fundit ka qenë kontributi i shoqërisë civile të shteteve që vlerësohen, respektivisht niveli i inkorporimit të inputeve të organizatave të shoqërisë civile. Për më tepër, shoqëria civile ende nuk po arrin të pozicionohet si aktor relevant për vlerësimin e progresit shtetëror, duke u kufizuar në një hapësirë që shpesh edhe marginalizohet nga institucionet shtetërore.

Faktori motivues i iniciativës për të përpiluar një raport vendor të progresit ishte dëshira për të dalë nga një pozicion minimalist, drejt një faktorizimi relevant, që shoqërinë civile e shndërron në ofruesin e pasqyrës alternative të progresit shtetëror. Në këtë mënyrë, përveç Raportit të Progresit të Komisionit Evropian, shteti i Kosovës do ta ketë edhe raportin kosovar të progresit, i cili reflekton perspektivën vendore mbi progresin. Disa nga risitë dhe përparësitë e organizatave që u angazhuan në hartimin e këtij raporti janë:

- aplikimi i instrumenteve dhe kriterëve tona të vlerësimit dhe matjes së progresit,
- evitimi i përdorimit të gjuhës politikisht korrekte ose neutrale,
- adresimi i problemeve më të rëndësishme (rrezikshme) që e pengojnë progresin,
- trajtimi i çështjeve të cilat nuk preken nga Raporti i Progresit të KE-së
- vlerësimi i rolit të prezencës së BE-së në Kosovë (konkretisht EULEX-it).

Në raport me përparësinë e fundit (vlerësimi i rolit të EULEX-it), shoqëria civile e Kosovës një kohë të gjatë ka adresuar paradoksin e vlerësimit të Kosovës nga KE-ja, duke e anashkuar misionin e vet qeverisës në Kosovë. Edhe pse me përgjegjësi direkte për sigurimin e sundimit të ligjit në Kosovë (çështje qendrore e Raportit të Progresit), EULEX-i nuk është pjesë e vlerësimit të Raportit të Progresit të KE-së. Raporti i Progresit *Made in Kosova* synon që të nxisë dialogun mes shoqërisë civile dhe Bashkimit Evropian në përpjekjet tona të përbashkëta për të përforcuar qeverisjen e mirë, ndërsa target kryesor ka institucionet shtetërore të Kosovës dhe duhet të pranohet si një kontribut modest për tejkalimin e pengesave ndaj funksionalitetit shtetëror të Kosovës.

1. MARRËDHËNIET KOSOVË - BE

1.1. Kosova në raport me integrimin evropian

Në tetor 2009, Komisioni Evropian publikoi raportin “Studim për Kosovën” si studim fizibiliteti që analizon zhvillimin e mëtutjeshëm politik dhe socio-ekonomik të Kosovës dhe parasheh asistencë Kosovës në përmbushjen e perspektivës Evropiane në linjë me rajonin. Nëpërmjet këtij dokumenti Kosovës iu hapën dy rrugë - fillimi i dialogut të vizave me perspektivë të liberalizimit eventual pasi të jenë përmbushur reformat e nevojshme; dhe krijimi i marrëveshjes së tregtisë ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës. Përsa i përket procesit të liberalizimit të vizave, Qeveria e Kosovës ka bërë një hap të rëndësishëm me përpilimin e Planit të veprimit për implementimin e udhërrëfyesit për procesin e liberalizimit të vizave që dëshmon gatishmërinë institucionale që të punohet drejt përfshirjes së Kosovës në proces. Prioritet i vitit që po vlerësohet në këtë raport ishte përqendrimi në zbatimin e marrëveshjeve për riatdhesim/integrimin e të kthyerëve që është kusht për përfshirjen e Kosovës në dialogun zyrtar për nisjen e liberalizimit të vizave (dhe që i njejtë kusht vlenë edhe për vendet në rajon në fazat e tyre fillestare). Derisa janë evidentuar disa arritje në përmbushjen e aktiviteteve në planin e veprimit, institucionet e Kosovës nuk kanë treguar përkushtim të duhur në respektimin e afateve të këtij plani si dhe kanë ngecur në planifikim real të mundësive/kapaciteteve institucionale. Ndonëse shtatori i vitit 2010 ishte caktuar si datë e mundshme për dhënien e Udhërrëfyesit për Kosovën (që në variantin konsensual do të quhet “Strategji për Liberalizimin e Vizave”), edhe fundi i muajit tetor po e gjen Kosovën pa orientim të saktë për marrjen e kësaj strategjie.

Në anën tjetër, sa i përket marrëveshjes së tregtisë me BE-në, dorëzimi i Pyetësorit për marrëveshje të tregtisë me 217 përgjigjet e ofruara nga qeveria e Kosovës ishte promovuar si një hap përpara drejt Bashkimit Evropian. Me këtë rast u dëshmuua se progresi në Kosovë matet me forcën e deklaratave publike dhe promovimin medial të zhvillimeve politike. Nëse analizohet përmbajtja e përgjigjeve të qeverisë dhënë pyetësorit të BE-së, përfundimi kryesor është se Kosova është larg të qenit treg i konkurrueshëm dhe atraktiv.

Edhe pse në Studimin për Kosovën, të publikuar në tetor të vitit të kaluar, Komisioni Evropian konstatoi se marrëdhëniet tregtare BE-Kosovë, bazuar vetëm në preferenca autonome tregtare nuk ofrojnë një perspektivë thelbësore për qëndrueshmërinë e zhvillimit afatgjatë ekonomik të Kosovës, KE-ja ka marrë vendim për zgjatjen e regjimit të tregtisë preferenciale me Kosovën deri në vitin 2015. Për më tepër, edhe pse në të njëjtin dokument thuhej se një perspektivë e zhvillimit afatgjatë ekonomik për Kosovën mund të ofrohet vetëm nëpërmjet një marrëveshje të tregtisë ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Kosovës, kjo perspektivë mbetet e paqartë dhe shumë pak e diskutuar deri sot. Marrëdhëniet tregtare qëndrojnë në thelb të çdo raporti, qoftë të partneritetit apo të integritit me Bashkimin Evropian. Siç dëshmojnë edhe të gjeturat e raporteve të monitorimit, treguesit tregtarë në Kosovë janë mjaft dekurajues. Përveç kësaj, administrata shtetërore e Kosovës ka mungesë të theksuar kapacitetesh për t'i ndërmarrë reformat e duhura në rritjen e konkurrueshmërisë tregtare të vendit. Vetëm në momentin e forcimit të pozitës konkurruese të Kosovës, BE-ja do ta konsiderojë vendin tonë si partner serioz për marrëdhënie të rëndësishme kontraktuale.

Njëkohësisht, edhe BE-ja duhet të tregohet e përkushtuar ndaj premtimeve të dhëna publikisht. Ofrimi i perspektivës për një marrëveshje tregtare në Studimin e Kosovës nuk është shoqëruar me ndonjë veprim konkret nga tetori i vitit të kaluar. Sikurse në rastin e procesit për liberalizimin e vizave, edhe perspektiva për marrëveshje të tregtisë BE - Kosovë duhet të zërthehet në dimensionin kohor dhe të obligimeve që duhet të përmbushen nga Kosova. Në rast se deshifrohet rruga e Kosovës drejt arritjes së kësaj marrëveshjeje, atëherë edhe BE-ja do ta ketë më lehtë të vlerësojë progresin e Kosovës, por edhe shoqëria civile do të mund të monitorojë në mënyrë më sistematike punën e bërë në këtë fushë.

1.2. Roli i EULEX-it

Definimi i rolit të vet si dhe përmirësimi i imazhit, mbetet një nevojë thelbësore për EULEX-in. Edhe pse i ngarkuar me ndërtimin e një sundimi të ligjit të fort dhe efektiv në Kosovë dhe për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, EULEX-i vazhdon të përballlet me shumë sfida operationale. Komunikimi i të drejtave dhe përgjegjësive të veta kundrejt publikut, si dhe përpjekjet për harmonizim me Qeverinë e Kosovës mbeten fushat ku EULEX-i duhet të bëjë përmirësime për të qenë i suksesshëm. Disa ngjarje të profilit të lartë kanë treguar se EULEX duhet të fitojë besimin e kosovarëve dhe zyrtarëve të qeverisë duke rritur transparencën dhe rezultatet e prekshme.

Perceptimi publik është se EULEX-i dhe qeveria e Kosovës janë në mosmarrëveshje kur është fjala për çështjen e nxehtë të korrupsionit të nivelit të lartë. EULEX-i dhe zyrtarë të qeverisë së Kosovës kanë lëshuar deklarata përcarëse në lidhje me arrestimin e mundshëm të zyrtarëve të lartë të qeverisë, jo vetëm në drejtim të mungesës së bashkëpunimit midis EULEX-it dhe institucioneve qeverisëse të Kosovës në luftimin e korrupsionit, por, në mënyrë brengosëse, edhe në aspektin e të drejtave të EULEX-it për ta bërë këtë. Sinjale të tilla të përziera kanë shërbyer vetëm për të ulur besimin e publikut në aftësinë e EULEX-it për të luftuar korrupsionin dhe rrezikon të forcojë ambientin mosndëshkimit në Kosovë.

Në nivelin themelor, reformimi i sistemit gjyqësor mbetet një proces i ngadaltë dhe ende një sfidë urgjente për EULEX-in dhe institucionet e Kosovës. Ndërsa të gjitha palët fajësojnë mungesën e vullnetit politik për të ecur përpara me reformat e nevojshme, është gjithashtu kritike nevoja për të rritur kapacitetet njerëzore përmes emërimit të më shumë prokurorëve dhe gjyqtarëve. Që nga prilli, EULEX-i morri 5 vendime (4 rastet penale dhe 1 civil), dhe shumica e këtyre janë dosje të transferua nga administrata e UNMIK-ut. Pa personelin e duhur, numri i lëndëve thjesht do të rritet, dhe kërkimi i drejtësisë në Kosovë do të mbetet një aktivitet që kërkohet jashtë kufijve të një sistemi funksional ligjor.

Çështja e Mitrovicës veriore mbetet e pazgjidhur. Mungesa e një gjykate funksionale në pjesën veriore të Mitrovicës simbolizon mungesën e ligjit dhe vullnetit politik të pamjaftueshëm për të siguruar drejtësinë në veri. Nevoja e BE-së, qeverisë së Kosovës dhe Serbisë për të bashkëpunuar në një frymë pragmatike ka qenë e kërkuar në nivele ndërkombëtare. Për fat të keq, EULEX-i nuk i ka penguar gjyqtarët e emëruar të Serbisë dhe prokurorët të veprojnë në gjykatat e veriut pavarësisht pjesëmarrjes së tyre në strukturat paralele. Konsultimet e EULEX-it me Beogradin nuk kanë arritur të marrin mbështetje për të lëvizur përpara me emërimin e gjyqtarëve që janë të pranueshme për të gjitha komunitetet, dhe si pasojë banorët në veri mbeten në një limbo gjyqësore.

Së fundi, EULEX-i duket i përmbajtur në detyrën e tij të menaxhimit të pikave të kalimit kufitar 1 dhe 31 në drejtim të kontrollit doganor dhe ruajtjen e integritetit territorial. Operationet kufitare të EULEX-it nuk kanë përparuar përtej praktikës së regjistrimit të thjeshtë të të hyrave doganore. Më tej, hyrja e paligjshme e serbëve gjatë festimeve të Vidovdan-it në qershor ka intensifikuar ndarjet midis EULEX dhe qeverisë së Kosovës rreth asaj se cili institucion është përgjegjës për të ndërhyrë në incidente të tilla.

EULEX është ende në procesin e përcaktimit të rolit të vet në sistemin e ndërlikuar Kosovar të qeverisjes. Në njërin anë pretendon të jetë vetëm një mision që merret me monitorim, mentorim dhe këshillim (MMK) në koordinim të plotë me qeverinë e Kosovës dhe prioritetet e saja, ndërsa në anën tjetër fillon veprime me dashje pa bashkëpunim me qeverinë e Kosovës. EULEX pa dyshim ka dështuar për të komunikuar pikërisht rolin e vet kundrejt qytetarëve të Kosovës, çka ka rezultuar në shpresa të mëdha dhe perceptime të rreme të përgjegjësive të veta nga ana e kosovarëve dhe zyrtarëve publik. Përdorimi i misioni ambicioz i EULEX-it për të ndihmuar në ndërtimin e një sundimi efektiv të ligjit dhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, do të kërkojë kohë përpara se efektet e tij janë ndjerë plotësisht, disa zhvillime kanë ilustruar nevojën e EULEX-it për të përmirësuar punën e vet në disa fusha.

Pamundësia e EULEX-it për të përmbushur mandatin e vet për të ndihmuar në ndërtimin e një gjyqësori të fortë dhe efektiv si dhe në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është bërë e qartë. Në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë, EULEX përsëri ka refuzuar të përdor funksionin e vet ekzekutiv për të dërguar as edhe një zyrtar të lartë publik në gjykatë pavarësisht nga shpresat e mëdha të krijuara më parë nga deklaratat e EULEX-it. Hetimi në vazhdim i ministrit Fatmir Limaj, i kryesuar nga Zyra e Prokurorit Special, është shembulli më i mirë i krizës së identitetit të EULEX-it. Më 28 prill, Departamenti i policisë së EULEX-it bastisi disa vende në Prishtinë, kryesisht Ministrinë e Transportit Postës dhe Telekomunikacionit (MTPT). Në një intervistë të mëvonshme në media, ushtruesi i detyrës së prokurorit të EULEX-it Johan van Vreeswijk, tha se ministri Limaj dhe kreu i departamentit të prokurimit në atë ministri, Nexhat Krasniqi, potencialisht mund të vuajnë 55 vjet burg me akuzën e pastrimit të parave, krimit të organizuar, ryshfetit dhe mashtrimit publik.¹ Prokurori Vreeswijk, gjithashtu i përmendi 6 ministri të tjera nën hetim, por kur ky raport po shkruhet, asnjë arrestim nuk është bërë deri me tani. Edhe pse zyrtarët e EULEX-it pohojnë nevojën për konfidencialitet dhe fajësojnë mediat për krijimin e supozimeve, këto sinjale të përziera shkaktojnë vetëm rënie të besimit lokal në kompetencat e EULEX-it.²

Pavarësisht se janë vënë në dukje shqetësime sidomos në fushën e reformës gjyqësore në Raportin e Programit të tij të 2010-së, EULEX ka qenë i ngathët në këtë fushë, duke dorëzuar vetëm pesë verdikte (4 penale dhe 1 civil) që nga prilli. Përveç kësaj, çështja e korrupsionit ka përvetësuar mediat dhe ka fituar vëmendje të fortë në diskursin publik. Disa raporte të shoqërisë civile të publikuara së voni kanë kritikuar EULEX-in dhe qeverinë e Kosovës për mos krijimin dhe zbatimin e plotë të një kornize gjithëpërfshirëse ligjore që efektivisht mbyll boshllëkun në procesin e prokurimit publik.³ Kërkesa në rritje për reforma të thella në prokurimet publike nuk është vetëm një burim kundërshtimesh ndër kosovarët, por tani nënvizon reputacionin ndërkombëtar të Kosovës dhe pranimin e mundshëm në institucionet evropiane. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) në draft rezolutën e fundit mbi Kosovën e konfirmon këtë mundësi shqetësuese me rekomandimet e tyre të qarta për EULEX-in dhe qeverinë e Kosovës për të marrë "masa konkrete" për përmirësimin e gjyqësorit, duke iu referuar Kosovës si vend që ka "standarde të ulëta".⁴

Reputacioni i EULEX-it ka marrë edhe një tjetër goditje me vendimin e tij të fundit në rastin Ivanoviç në lidhje me djegien e kalimeve kufitare në Portat 1 dhe 31. Sipas EULEX-it, "nuk janë gjetur fakte" të cilat do të vërtetojnë akuzat ndaj kryetarit të Këshillit Kombëtar Serb, Milan Ivanoviç, i akuzuar për organizimin, përkrahjen dhe pjesëmarrjen në terrorizëm, dhe nxitje të urrejtjes.⁵ Kjo është parë si "drejtësi selektive" nga mediat si dhe nga shumë shqiptarë të Kosovës.⁶ Së fundi, EULEX ka arritur disa rezultate pozitive. Më 10 maj 2010 EULEX-i ka ndihmuar për të gjetur një varr masiv në Vushtrri ku tetë persona u zhvarrosën, hetimi kishte qenë në vazhdim e sipër që nga viti 2009.⁷ Përveç kësaj, EULEX-i dhe Policia e Kosovës, në bashkëpunim me autoritetet shqiptare dhe nën mbikëqyrjen e Zyrës së Prokurorit të Posaçëm, vazhdojnë të arrestojnë individë në Shqipëri dhe Kosovë për krime të luftës të dyshuara që

¹ "EULEX: Limaj mund të përballen me një burgim afatgjatë," BalkanInsight. 7 Maj 2010

² Intervistë me anëtarët e personelit të EULEX-it

³ Shih dy raportet e fundit të IPOL-it: "Konkurrenca: Korniza ligjore dhe praktika në Kosovë krahas standardeve Evropiane," dhe "Mbrojtja e Konsumatorit: Korniza ligjore, sfidat në Kosovë dhe standardet e BE-së.", IKS raporti, "zgjdhja e njëjës: Ekonomia Politike e Korrupsionit në Kosovë."

⁴ Situata në Kosovë dhe rolin i Këshillit të Evropës, "Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës. 21 qershor 2010. Shikuar në: www.assembly.coe.int/Documents/WorkingDocs/Doc10/EDOC12302.pdf

⁵ Telegrafi, Standarde të dyfishta të Drejtësisë të EULEX-it, 2010/07/08. Shikuar në: <http://www.telegrafi.com/?id=2&a=9377>

⁶ Telegrafi, Standarde të dyfishta të Drejtësisë të EULEX-it, 2010/07/08. Shikuar në: <http://www.telegrafi.com/?id=2&a=9377>

⁷ Mbetjet e Tetë Individët janë zhvarrosur, "EULEX. 12 maj 2010. Shikuar në: www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases

kanë ndodhur në vitin 1999⁸. Po ashtu, në vjeshtë ka patur lëvizje nga EULEX, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in, për të bërë hapa për të luftuar krimin e organizuar në veri të vendit.

⁸ EULEX- dhe Policia e Kosovës ben arrestime të mëdhane çështjen kimit të organizuar, "EULEX-it. 27 maj 2010. Shikuar në: www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0064.php

2. PROGRESI POLITIK DHE INSTITUCIONAL

2.1. Kuvendi

Institucioni më i lartë përfaqësues në vend tani gati po hyn në vitin i cili do të shënon dekadën e parë të jetës së tij si një institucion përfaqësues dhe me premisa të një institucioni demokratik. Që nga konstituimi i Legjislaturës së parë pas përfundimit të luftës në Kosovë, Kuvendi i Kosovës vazhdimisht po përballlet me sfida dhe probleme të vazhdueshme në ndërtimin e një institucioni i cili do të ishte pishtar i vlerave demokratike në Kosovë. Fatkeqësisht problem të shumta po e përcjellin edhe në ditët e sotme. Paaftësia për të realizuar planin legjislativ të punës së tij, cilësia jo e mirë e ligjeve të miratuara, kontrolli tejet i dobët parlamentar ndaj qeverisë, mos përcjellja e zbatimit të ligjeve në praktikë, degradimi i rekomandimeve apo qëndrimeve të Kuvendit nga ana e Qeverisë, janë fakte të cilat asesi nuk po mund ta këndellin këtë institucion në kryerjen e obligimeve sipas kompetencave të garantuar me rendin juridik në Kosovë.

Plan i Legjislativ i Kuvendit

Një prej problemeve kryesore që është duke e përcjellë punën e Kuvendit është mosarritja e përmbushjes së planit të tij të punës. Një pjesë të fajit për këtë e bart qeveria e Kosovës, e cila nuk i përcjellë me kohë projektligjet ashtu siç janë paraparë me strategjinë legjislative. Sidoqoftë, jo vetëm qeveria e Kosovës është përgjegjëse për mos-përmbushje të planit të punës së Kuvendit të Kosovës. Një numër i konsiderueshëm i projektligjeve qëndrojnë për vite të tëra në sirtarë të ndryshëm dhe për arsye të ndryshme në Kuvendin e Kosovës. Pothuajse se për asnjë projektligj që shqyrtohet në Kuvend, nuk respektohet periudha e paraparë prej dy muajsh nga leximi i parë në leximin e dytë të projektligjit. Për vonesat në miratimin e ligjeve, Kuvendi zakonisht e fajëson Qeverinë për dërgim me vonesë në Kuvend dhe për cilësinë e dobët të projektligjeve, të cilat pastaj kanë nevojë për shumë amendamente. Madje në Kuvend thuhet se vonesat ndodhin edhe për shkak “të ndërhyrjeve që vijnë jashtë Kuvendit”⁹, pa specifikuar se kush janë ato trupa.

Me programin e Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2010, për periudhën janar - qershor, janë paraparë të shqyrtohen 56 projektligje. Megjithatë, vetëm 24 prej tyre janë shqyrtuar (2 prej të cilave e kanë kaluar edhe leximin e dytë, ndërsa 22 të tjera vetëm leximin e parë). Prej 22 ligjeve që e kanë kaluar leximin e parë, shtatë prej tyre e kanë kaluar periudhën prej dy muajsh të paraparë me rregullore të Punës së Kuvendit për shqyrtim të një ligji nga leximi i parë në të dytin.

Kontrolli parlamentar i Qeverisë

Kontrolli parlamentar ndaj qeverisë është kompetencë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Pavarësisht kompetencave kushtetuese, Kuvendi i Kosovës ende nuk po mund të gjejë forma dhe vullnet për ushtrimin e tyre, me theks të veçantë rolin mbikëqyrës mbi pushtetin ekzekutiv. Kuvendi i Kosovës edhe më tutje ballafaqohet me mosgatishmërinë e ministrave të kabinetit qeveritar për t’iu përgjigjur pyetjeve parlamentare të deputetëve, mosgatishmërinë e tyre për të qenë prezent në seanca plenare kur trajtohen çështje që dalin nga fushë veprimtaria e tyre, mospërgjigja ndaj ftesave të komisioneve parlamentare për të raportuar në mbledhjet e tyre e deri tek injorimi apo degradimi i rekomandimeve apo qëndrimeve që dalin nga institucioni më i lartë përfaqësues në vend.¹⁰

Pyetjet parlamentare

Deputetët e Kuvendit të Kosovës gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre në mbikëqyrjen parlamentare të Qeverisë edhe më tutje si formën më të shpeshtë i përdorin pyetjet parlamentare. Megjithatë problem i zakonshëm është mungesa e ministrave në seanca plenare për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve. Shembull më konkret për këtë ishte seanca e datës

⁹ Kryesia e Kuvendit të Kosovës. 2010. Proceverbali i mbledhjes së mbajtur me datën 20 prill 2010

¹⁰ “Zbatimi i Planit të Veprimit për Integritet Europian nga ana e Kuvendit të Kosovës” - Publikim i KDI-së

11 shkurt 2010, ku gjatë kohës së pyetjeve parlamentare nga kabineti qeveritar ishin të pranishëm vetëm pesë ministra, ndërsa nga njëzeteshtatë pyetje të deputetëve vetëm tri prej tyre morën përgjigje.¹¹

Interpelancat

Deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë të drejtën e mbikëqyrjes-kontrollit parlamentar të Qeverisë përmes Interpelancave parlamentare me qëllim të shqyrtimit të një çështjeje që është në kompetencën e punës së Qeverisë në përgjithësi apo të një ministrie në veçanti. Megjithatë përkundër ekzistimit të kësaj të drejte e cila në vendet me demokraci të konsoliduar konsiderohet si një nga instrumentet më të rëndësishme të kontrollit parlamentar të Qeverisë, Kuvendi i Kosovës përkatësisht deputetët as gjatë vitit 2010 nuk e kanë shfrytëzuar këtë formë të mbikëqyrjes parlamentare.

Monitorimi i zbatimit të ligjeve

Kuvendi i Kosovës përkatësisht komisionet parlamentare e kanë të përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit të drejtën dhe detyrën për të monitoruar zbatimin e ligjeve në praktikë nga ana e organeve kompetente. Megjithatë këtë të drejtë dhe obligim komisionet parlamentare po vazhdojnë ta neglizhojnë duke monitoruar një numër tejet simbolik apo duke mos monitoruar fare asnjë ligj që del nga kompetencat dhe fushë veprimtaria e secilit komision në veçanti. Gjatë kësaj periudhe raportuese shumica e komisioneve parlamentare në planet e tyre të punës të miratuara në fillim të vitit kishin planifikuar monitorimin e zbatimit të ligjeve në praktikë nga ana e organeve kompetente. Mirëpo, përkundër planifikimit asnjë nga komisionet parlamentare nuk e kanë përfunduar së monitoruari ndonjë ligj, madje shumë nga ta një proces të tillë nuk e kanë filluar fare.¹²

Transparenca

Kuvendi i Kosovës vazhdon të jetë pjesërisht transparent sa i përket punës së vetë. Seancat e Kuvendit të Kosovës vazhdojnë të transmetohen nga Radio Televizioni i Kosovës (RTK) vetëm deri në orën 17. Përkundër asaj që transmetimi i gjatë i seancave plenare do të ndikonte në skemën programore të RTK-së, duke e pasur parasysh që çështjet që diskutohen në Kuvend të Kosovës janë për interes të përgjithshëm qytetar, RTK do të duhej që të vazhdonte të transmetonte seancat e Kuvendit të Kosovës edhe pas orës 17. Mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit vazhdojnë të mbesin të mbyllura për organizatat e shoqërisë civile vendore, përderisa ato mbesin të hapura vetëm për organizatat dhe institucionet ndërkombëtare si, OSBE, NDI dhe ICO.

Votat elektronike vazhdojnë të mos publikohen me kohë. Madje në këtë aspekt situata është përkeqësuar, pasi që në periudhën janar-qershor 2010 nuk janë publikuar votat elektronike për asnjë seancë të Kuvendit të Kosovës. Mos publikimi i votave elektronike është shkelje e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, përkatësisht të Nenit 52, pika 7 e cila shprehimisht thotë “Publikimi i votimit elektronik të deputetëve, bëhet brenda tri ditë pune, pas mbledhjes plenare”. Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë publikohen me shumë vonesë (përderisa ka edhe procesverbale që nuk publikohen fare si ai i datës 23 mars 2010). Në anën tjetër, edhe pse Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës përgatit transkripte nga mbledhjet e saj, ato nuk publikohen. Komisionet parlamentare po ashtu nuk publikojnë me kohë procesverbalet nga mbledhjet e komisioneve dhe informatat e ofruara në ato procesverbale jo-rrallë herë janë të mangëta. Po ashtu ka edhe raste kur lajmërimet për mbledhje të komisioneve bëhen më shumë vonesë apo në rastet me të këqija nuk bëhen fare. Kuvendi i Kosovës vazhdon të mos jetë transparent as në publikimin e raporteve të shpenzimeve të këtij institucioni.¹³

¹¹ Fletnotimi – Publikim i KDI-së, korrik 2010

¹² Fletnotimi – Publikim i KDI-së, korrik 2010

¹³ Fletnotimi – Publikim i KDI-së, korrik 2010, f.13

2.2. Qeveria

Në mars, partitë e koalicionit u dakorduan për ndryshimin e bartësve të disa ministrive. Nga Qeveria e Kosovës u larguan gjashtë ministri dhe u zëvendësuan me gjashtë të tjerë. Shumica e ministrave dhe zëvendësministrave të larguar u sistemuan sërish në poste ekzekutive në Qeveri. Më 2 prill Qeveria e Kosovës themeloi Ministrinë e Integritetit Evropian duke bërë që numri i ministrive në shtetin e vogël të Kosovës të arrijë në 18. Ministria e Integritetit Evropian do të jetë bartëse e procesit të integritetit, mirëpo MIE do të ketë vetëm rol koordinues dhe jo imponues ndaj ministrive tjera.

Afro tri vite pas shpalljes së pavarësisë, ekzekutivi i vendit vazhdon të funksionoj me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse. Projektligji për Qeverinë është miratuar në Qeverinë e Kosovës në shkurt 2009. Pas dërgimit të tij në Kuvend ai është tërhequr mbresa nga ana e Qeverisë.

Rregullat e brendshme procedurale të Qeverisë së Kosovës edhe më tutje bazohen në Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës të miratuar më 2007. Në shumë pika kjo rregullore është jo transparente dhe jo demokratike. Me anë të kësaj rregulloreje nuk parashihet që shoqëria civile dhe mediat të marrin pjesë në mbledhjet e Qeverisë së Kosovës. Mediat kanë mundësi që mbledhjet e Qeverisë të ndjekin nga një ekran që ndodhet në hapësirat. Në shumë raste Qeveria nuk ndez mikrofonat gjatë debateve, me qëllim që të mos kuptohet pjesë të caktuara të diskutimeve. Rregullorja e Punës së Qeverisë gjithashtu nuk lejon publikimin e procesverbale të mbledhjeve të Qeverisë, duke i klasifikuar at si dokumente konfidenciale. Gjithashtu, Rregullorja e Punës së Qeverisë nuk parashihet afat kohor nga dita miratimit të një projektligji në Qeveri deri në ditën e dërgimit të tij në Kuvend. Në mungesë të një afati të tillë ligjor, Qeveria e Kosovës gjatë këtyre tri viteve të funksionimit nuk ka ndjekur procedurë të rregullt të dërgimit të projektligjeve në Kuvend. Projektligji që më së shpejti është dërguar në Kuvend është Projektligji për Qeverinë e Kosovës (brenda 6 dite nga dita e miratimit), kurse më së gjati kohë ka marrë Projektligji për Qytetin e Prishtinës (pas 432 ditësh nga dita e miratimit të tij në Qeveri). Me rastin e Projektligjit të Prishtinës, Qeveria e Kosovës ka bërë edhe shkelje tjera, si për shembull, Projektligji për Prishtinën i dërguar në Kuvend dallon në së paku dy pika nga ai i miratuar në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës. Këto ndryshime të bëra në tekst nuk janë aprovuar pastaj nga Qeveria para se projektligji të dërgohej në Kuvend. Qeveria e Kosovës nevojitet që në afat sa më të shpejtë të miratoj Ligjin për Qeverinë e Kosovës dhe në bazë të këtij ligji të hartoj edhe rregulloren e re të punës.

Edhe këtë vit Qeveria e Kosovës nuk ka arrit që të respektoj Strategjinë Legjislative të Qeverisë për 2010. Deri në mbledhjen e fundit të Qeverisë së Kosovës¹⁴, Qeveria ka miratuar 57 projektligje apo vetëm 42% e Strategjisë Legjislative. Qeveria e Kosovës nuk ka arrit që të miratoj edhe 79 projektligje tjera nga kjo Strategji. Edhe miratimi i projektligjeve nuk është bërë konform afateve kohore që parashihen në strategji. Kjo ka ndikuar që mos të respektohen edhe planet e punës së Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës. Qeveria e Kosovës nevojitet që në vitet në vazhdim të miratoj një strategji legjislative e cila përmban numër më të pakët të projektligjeve dhe ato të dërgoj me kohë në Kuvend.

2.3. Administrata Publike

Edhe më tutje Qeveria e Kosovës mbetet punëdhënësi më i madh në vend. Administrata publike në nivel lokal dhe qendror është e tejngarkuar me staf. Përkundër angazhimit të projektit FRIDOM për rishikimin funksional të administratës, Qeveria e Kosovës nuk ka arrit që të marr masa për reformimin e administratës publike.

Në dhjetor 2008 Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për caktimin e kritereve për numrin e punonjësve nëpër administrata lokale, ky vendim nuk është respektuar nga komunat, gjersa

¹⁴ Mbledhja e 147, mbajtur më 5 tetor 2010.

Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk ka marrë hapa për monitorimin e zbatueshmërisë së këtij vendimi të Qeverisë.¹⁵

Kuvendi i Kosovës pas shumë zvarritjeve ka miratuar dy ligje më rendësi të shërbimit civil, siç janë Ligji për Shërbimin Civil dhe Ligji për Pagat e Shërbyesve Civil. Megjithatë këto ligje do të hyjnë në fuqi nga janari i 2011.

Qeveria e Kosovës edhe më tutje nuk ka marrë masa në emërimin e sekretarëve të përgjithshëm nëpër ministri. Më 15 shtator Qeveria ka miratuar Rregulloren për Procedurat e Emërimit në Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mirëpo edhe më tutje asnjë sekretar nuk është zgjedhur konform kësaj rregulloreje. Pothuajse të gjitha ministratë operojnë me ushtrues detyre të sekretarit, ushtrues detyre të cilët janë emëruar nga ministrat. Kjo ka bërë që shërbimi civil të politizohet.

E njëjta situatë vërehet edhe në nivel komunal. Pas ndryshimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, udhëheqësia komunale e dalë pas zgjedhjeve të nëntorit-dhjetorit 2009, në asnjë komunë nuk kanë shpallur konkurs për menaxher personeli, post i cili në bazë të ligjit është post i konkursit. Me ndryshimet e parapara në Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, parashihet që drejtorët e administratës të zgjidhen në bazë të konkursit, e jo siç ka qenë deri më tani që ata të jenë të emëruar politik. Këto ndryshime të shpeshta në ligjin për vetëqeverisje lokale kanë krijuar konfuzion dhe ndërhyrje të politikës në shërbimin civil komunal.

Edhe më tutje, pranimet në shërbimin civil bëhen në baza nepotizmi dhe përkatësie partiake, duke lënë shumë pak hapësirë për rekrutime të ndershme. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës në shumë raste është treguar i ngadalshëm duke shtyrë me vite vendimet për të larguarit apo të pranuarit në procedurë të jo të rregullt në shërbimin civil.

Qeveria e Kosovës duhet të marrë masa në zbatimin e planeve strategjike, rishikimeve horizontale dhe vertikale të administratës, të bëra nga projekti FRIDOM, me qëllim të reformimit të administratës publike në nivel qendror dhe lokal.

2.4. Menaxhimi i zgjedhjeve

Në aspektin e organizimit dhe mbikëqyrjes së zgjedhjeve, zgjedhjet lokale për këshilltarë të Kuvendeve Komunale dhe për Kryetar Komune të vitit 2009 janë zgjedhjet e para ku institucionet kosovare, përkatësisht, Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), ka mbajtur përgjegjësinë e plotë për organizimin dhe administrimin e tyre. Ligjet kryesore që rregullojnë procesin zgjedhor në Kosovë janë: Ligji mbi Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligji mbi Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të cilat janë miratuar në qershor 2008 bazuar në predispozitat e Propozimit Gjithpërfshirës të Marrëveshjes për Kosovën të përgatitur nga i dërguari special i OKB-së, presidenti Ahtisari.

Zgjedhjet e fundit lokale të organizuara në Kosovë në nëntor të vitit të kaluar, nxorën në pah një numër të madh problemesh dhe parregullsish që në përgjithësi dëmtojnë imazhin e procesit zgjedhor dhe si rezultat nxorën nevojën për rishikimin e legjislacionit aktual.¹⁶ Këto zgjedhje kanë qenë të monitoruara nga rrjeti i organizatave vendore të shoqërisë civile “Demokracia në Veprim” dhe një numër i vogël i vëzhguesve nga ENEMO.¹⁷ Nga raportet e institucioneve monitoruese të zgjedhjeve ku janë evidentuar shumë probleme dhe parregullsi gjatë procesit zgjedhor, ka dalë si konkluzion nevoja për reformimin e legjislacionit aktual zgjedhor. Ky proces tani është në fazën fillestare, mirëpo rrethanat politike të krijuara në vend, nuk japin shpresë të një reforme të mirëfilltë të këtij legjislacioni.

¹⁵ Vendimi 10/46 i 3 dhejtorit 2008.

¹⁶ Reforma në sistemin zgjedhor të Kosovës – Punim i KDI-së

¹⁷ ENEMO- (Rrjeti i Organizatave Europiane për monitorimin e zgjedhjeve).

Sistemi zgjedhor

Kosova me Ligjin aktual zgjedhor përcaktohet si një zonë e vetme zgjedhore. Kërkesat për ndryshimin e këtij sistemi sa vinë e po rriten me arsyetimin se krijimi i më shumë zonave zgjedhore do të kishte përparësi të mëdha, ku më kryesorja do të ishte rritja e përfaqësimit të qytetarëve dhe ndërlidhja me e madhe në mes të deputetëve dhe qytetarëve. Me sistemin aktual zgjedhor, lidhja ndërmjet deputetëve dhe zgjedhësve të tyre është mjaft e dobët, për të mos thanë që nuk ekziston fare. Megjithatë përkundër përpjekjeve dhe insistimeve të vazhdueshme të shoqërisë civile për krijimin e më tepër zonave zgjedhore, deri më tani një çështje e tillë nuk ka pasur sukses dhe nga zhvillimet e fundit në Grupin Punues për Zgjedhje¹⁸ është kuptuar se një çështje e tillë nuk do të ndryshojë fare edhe për zgjedhjet e ardhshme që do të mbahen brenda disa muajve.

Votimi me kusht

Neni 95 i Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme i jep votuesit një mundësi të votojë me kusht nëse nuk gjendet në listën e votuesve. Votimi me kusht është një zgjidhje që shpesh përdoret në mjediset pas konflikteve për t'iu dhënë votuesve mundësinë të votojnë edhe pse ai/ajo nuk është në listën e votuesve ku ai/ajo pretendon se ka të drejtë të votojë. Votimi me kusht ka shumë mangësi dhe zakonisht vonon shpalljen e rezultateve të numërimit dhe paraqet një rrezik potencial për manipulime dhe ndikon në uljen e besimit në tërë procesin.

Komisioni Qendror Zgjedhor

KQZ-ja është përgjegjëse për përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve. Në përgjithësi, KQZ-ja ka treguar një nivel të lartë të angazhimit gjatë përgatitjes së zgjedhjeve të fundit të organizuara në Kosovë. Rekrutimi dhe trajnimi i stafit administrues dhe vend votues në zonat jo serbe si dhe prokurimi i materialit në përgjithësi janë bërë në mënyrë të duhur. Ndër mangësitë kryesore që e kanë përcjellë punën e KQZ-së gjatë përgatitjeve zgjedhore kanë qenë vonesa e informimit të qytetarëve në lidhje me ndërrimet e vendvotimeve, vonesat në edukimin e qytetarëve për të votuar, trajnimi jo adekuat i komisionarëve zgjedhor si dhe vonesat në përgatitjet për funksionalizimin e Qendrës së Numërimit të Rezultateve (QNR). Vonesa në shpalljen e rezultateve ka qenë më e theksuar në balotazhin për kryetar komune, ku në rastin e Gjilanit kjo ka zgjatur më shumë se një muaj.¹⁹

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

KZAP-i, si organ i përhershëm dhe i pavarur ka pasur vështirësi të shumta në funksionalizimin e vetë. Si rezultat i mosalokimit me kohë të buxhetit për këtë institucion, KZAP-i është ballafaquar me një mori vështirësish që kanë shkaktuar probleme në funksionalizimin e tij, duke filluar që nga mungesa e stafit administrativ e deri tek mungesa e hapësirës së nevojshme për të ushtruar funksionet dhe detyrat e veta në mënyrë të duhur. Mungesa e transparencës së KZAP-it ka qenë një problem permanent. Në përfundim mendimi i gjerë është që vonesat në certifikimin e rezultateve kanë qenë si pasojë e vonesave të KZAP-it për të marrë vendime të shpejta për të gjitha ankesat e parashtruara para këtij organi, e që automatikisht ka bllokuar certifikimin e rezultateve të raundi të parë por edhe të balotazhit.

Listat e votuesve

Numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar për zgjedhjet e 2009 ka qenë 1.563.741. Edhe pse KQZ-ja ka bërë një punë të mirë për pastrimin e listave të votuesve ky problem ende është mjaft i pranishëm. Procedurat ligjore shumë të ndërlikuara dhe të gjata për shtimin ose fshirjen e të dhënave në listat e votuesve mbesin një sfidë. Në anën tjetër, në shumë vendvotime janë evidentuar rastet kur votuesit nuk kanë arritur të gjejnë emrat e tyre në listat

¹⁸ Grupi Punues për Zgjedhje – është trup ku janë përfaqësuar të gjitha partitë politike parlamentare dhe Shoqëria civile

¹⁹ Demokracia në Veprim “Raporti i zgjedhjeve komunale 2009” fq.11

e votuesve. Sipas vëzhguesve të DV në 36% të vendvotimeve kjo ka ndodhur shpesh, në 40% ka ndodhur pak, dhe në vetëm 14% të vendvotimeve rrallë.²⁰

Fushata zgjedhore

Periudha para zgjedhore është shënuar me fushatë dinamike dhe aktive të kandidatëve dhe partive politike, duke shkuar nga tubimet e mëdha në zonat urbane deri te tubimet më pak formale dhe diskutimeve me njerëz në rrugë, restorante, dhe vende ku qytetarët mbledhen. Çështjet më brengosëse të fushatës, kanë qenë përdorimi i fëmijëve në aktivitetet parazgjedhore të partive politike, nga të gjitha partitë e mëdha dhe përdorimi i veturave publike nga zyrtarë të ndryshëm për qëllime partiake. Gjatë fushatës janë vërejtur raste kur zyrtarë komunalë që nuk kanë dhënë dorëheqje nga postet e tyre marrin pjesë në fushatë si kandidatë politikë. Po ashtu janë vërejtur që disa zyrtarë komunalë marrin pjesë në tubime partiake gjatë orarit të punës.

Dita e votimit

Përkundër faktit që u përmbushën shumica e standardeve universale për zgjedhje të lira, të drejta dhe të barabarta, dita e zgjedhjeve në Kosovë u karakterizua me një varg shkeljesh, ku sipas të dhënave, kryesisht kanë qenë të natyrës së njëjtë në shumicën e vendvotimeve, përveç disa qendrave ku shkeljet ishin më të rënda. Sipas të dhënave të mbledhura nga “Demokracia në Veprim” parregullsi gjatë ditës së zgjedhjeve ka pasur në 126 vendvotime ose në 5.6% të totalit të vendvotimeve.²¹ Në aspektin procedural të përgatitjes së vendvotimeve, problemi kryesor i raportuar nga vëzhguesit ka qenë sigurimi i qasjes fizike në vendvotim për persona me aftësi të kufizuara - kjo mangësi është raportuar nga 25 përqindësi i vendvotimeve. Probleme tjera të identifikuar kanë qenë mos kontrollimi i dokumenteve identifikuese, mungesa e materialit në vendvotime, votimi më shumë se një herë, prezenca e vazhdueshme e personave të paautorizuar në vendvotime, votimi familjar, asistimi i votuesve nga ana e vëzhguesve të partive politike, keqpërdorimi i pozitës së menaxherëve të qendrave të votimit, votimet e hapura dhe fotografimi i votave nga shoqëruesit e votuesve. Ndërsa sa i përket numërimit, problemi që është vërejtur në më shumë vendvotime, kanë qenë fletëvotimet e prishura dhe të refuzuara që nuk u numëruan dhe nuk u regjistruan fare.

Rivotimet në komunën e Prizrenit, Lipjanit dhe Gjilanit

Parregullsitë e gjetura në raundin e dytë të zgjedhjeve në dhjetor 2009 në komunat e Prizrenit, Lipjanit dhe Gjilanit kanë zbehur në një masë parimet e zgjedhjeve të lira dhe të drejta. Kjo ka bërë që për herë të parë që nga zgjedhjet e para të vitit 2000 të anulohen rezultatet complete në dy komuna, duke u vendosur për rivotim (raund i tretë). Procesi i rivotimit në komunat e Prizrenit, Lipjanit dhe Gjilanit i kanë përmbushur kënaqshëm standardet për zgjedhje të lira dhe të drejta, përkundër disa parregullsive që janë vërejtur.

2.5. Sundimi i ligjit²² dhe sistemi i drejtësisë

Kjo pjesë ka për qëllim të vlerësoj periudhën një vjeçare të Sundimit të ligjit dhe sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës. Në kuadër të këtij fushëveprimi, Qeveria e Republikës së Kosovës që nga tetori i vitit të kaluar, ka shënuar një progres të ngadaltë në hartimin e legjislacionit si dokument bazik, përderisa mungon një lëvizje pozitive dhe rezultate konkrete

²⁰ Demokracia në Veprim “Raporti i zgjedhjeve komunale 2009” fq.12

²¹ Demokracia në Veprim “Raporti i zgjedhjeve komunale 2009” fq.6

²² Nga definicionet e shumta që i bëhen kësaj fushe të së drejtës, Asociacioni Ndërkombëtar i Avokatëve definojnë Sundimin e ligjit në bazë të këtyre parimeve: Një gjyqësor të paanshëm dhe të pavarur, prezumim i pafajësisë, të drejtën për një gjykim të drejtë dhe publik pa vonesë në kohë, një qasje racionale dhe proporcionale me dënim, një profesion të fortë dhe të pavarur ligjor, mbrojtja e rreptë e komunikimit konfidencial midis avokatit dhe klientit, barazinë e të gjithë para ligjit, të gjitha këto janë parimet themelore të sundimit të ligjit. Kështu, arrestimet arbitrare, gjykimet e të fshehta, të pacaktuar burgimi pa gjykim, trajtim mizor ose degradues ose ndëshkimit, frikësimit ose të korrupsionit në procesin zgjedhor, janë të gjitha të papranueshme. Sundimi i ligjit është baza e një shoqërie të civilizuar. Ai krijon një procesi transparent të arritshme dhe të barabarta për të gjithë. Ajo garanton respektimin e parimeve që të dy të çliuar dhe mbrojtur.

në implementimin e legjislacionit dhe funksionalizimin e gjyqësorit. Në përgjithësi mungon një koherencë e progresit në Sundimin e ligjit që realizohet në veriun e Kosovës dhe në pjesën tjetër territoriale të vendit.

Në kuadër të hartimit të legjislacionit, Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, sikurse edhe në vitet paraprake, kanë treguar përkushtimin e vërtet vetëm në përfundim të afateve kohore para hartimit të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian 2010. Përkatesisht, pjesa dërrmuese e legjislacionit që lidhen me sistemin e drejtësisë në vend janë miratuar nga Qeveria dhe Kuvendit i Kosovës vetëm nga korriku, respektivisht nga shtatori 2010.

Sa i përket reformave të gjyqësorit, Kuvendi i Kosovës në korrik të këtij viti ka miratuar Ligjin për Gjykatat, ndërsa po ky ligj është dekretuar nga Presidenti vetëm në muajin gusht. Pakoja tjetër e ligjeve të gjyqësorit ku hyjnë: Ligji për Prokurorinë, Ligji për Këshillin Prokurorial dhe Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës janë aprovuar nga Qeveria e Kosovës, përderisa Kuvendi ka kaluar vetëm leximin e parë të tyre. Në një dinamikë më të ngadaltë është punuar në finalizimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, ndërkaq nuk dihet afati i saktë për miratimin e tyre.

Hartimi i këtij legjislacioni, padyshim se paraqet shtyllën e reformimit të sistemit gjyqësor në Kosovë. Megjithatë, dinamika e implementimit të tyre nuk len shumë hapësirë për një applaudim të hershëm të fryteve që mund t'i sjellë kjo punë e Qeverisë. Në këtë drejtim, përkundër që Ligji për Gjykatat është aprovuar nga të gjitha institucionet respektive të vendit, për shkak të ndryshimit të tërësishëm të sistemit gjyqësor që parasheh ky ligj, hyrja e plotë e këtij ligji në fuqi parashihet vetëm në Janar të vitit 2013²³. Pakoja e tre ligjeve të gjyqësorit, pas miratimit të tyre, parashihet të hyjë në fuqi në një periudhë më të shpejtë kohore²⁴, përkatësisht deri në fillim të vitit të ardhshëm, andaj shumë shpejt mbetet të shihet përkushtimi i Qeverisë për reformimin e plotë të gjyqësorit. Po këtë vit, është përfunduar me sukses faza e parë dhe e dytë e emërimit dhe ri-emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj, ndërkaq nuk ka indikacione konkrete se kur do të përfundojë faza e fundit e emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës.

Një ndër problemet me të cilat vazhdon të ballafaqohet gjyqësori i vendit, padyshim se është ngarkesa me *dosjet e mbetura gjyqësore* dhe numrin e kufizuar të gjyqtarëve dhe prokurorëve për rritjen e dinamikës së punës në këtë drejtim. Me qëllim të reduktimit të dosjeve të mbetura gjyqësore, është hartuar draft-rregullorja për zbatimin e normave dhe shpërndarjen e lëndëve të mbetura e cila ende nuk ka marrë aprovimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Hartimi dhe miratimi i legjislacionit paraqet vetëm kornizat bazë të sistemit që do të ndjekë vendi ynë në reformimin e gjyqësorit. Ndërkaq pjesa qenësore për krijimin e një sistemi modern gjyqësor padyshim se i mbetet vet pushtetit gjyqësor të cilët duhet të rrisin performancën e tyre dhe të jenë më llogaridhënës për kompetencat dhe mandatin që ushtrojnë dhe pushtetit ekzekutiv. Në këtë mënyrë, duhet ta krijohen kushtet e punës së gjyqësorit dhe prokurorisë nëpërmjet rritjes së pagave, ofrimit të mbrojtjes fizike të tyre dhe familjarëve të tyre dhe të mos interferojnë në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.

Në përgjithësi, Qeveria e Kosovës ende nuk ka treguar seriozitet në trajtimin më të mirë të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës. Kjo ka rezultuar në dështimin e gjyqësorit gjatë rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinjë, të cilët nga indikacionet e përgjithshme vërehet se nuk kanë arritur të marrin një grup të juristëve profesional dhe me shkollim superior, pikërisht për shkak të pagave të ulta në sistemin gjyqësor dhe mungesës së kushteve elementare për ushtrimin e funksionit të tyre. Këto dobësi e vështirësi e vendosin gjyqësorin në

²³ Neni 41 i Ligjit për Gjykatat

²⁴ Sipas neni 45 të Ligjit për Këshillin Prokurorial, ky ligj hyn në fuqi me 1 Janar 2011; Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke u bazuar në nenin 56 të këtij ligji, hyn në fuqi 6 muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare; Në bazë të neni 35 të Ligjit për Prokurorinë e Shtetit, ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare

një pozitë, ku qytetari në vazhdimësi e humb besimin për mungesën e profesionalizimit dhe objektivizmit të gjyqësorit.

Në kuadër të *bashkëpunimit juridik ndërkombëtar*, sistemi i drejtësisë në vend është sfiduar shpeshherë nga kërkesat dhe provokimet e vazhdueshme të Serbisë për ekstradimin e qytetarëve kosovar të akuzuar jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Si rezultat i veprimeve ad hoc të institucioneve të vendit, nuk ka ndodhur që qytetarët kosovar të ekstradohen në Republikën e Serbisë, megjithatë mungesa e Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar dhe posaçërisht mungesa e nënshkrimit të marrëveshjeve për ekstradim ndërmjet Kosovës dhe shteteve të tjera paraqet një sfidë të veçantë për vendin në ushtrim të sovranitetit të saj dhe mbrojtjes së qytetarëve kosovar të akuzuar jashtë vendit. Deri më tani, vetëm disa marrëveshje bilaterale janë evidentuar.

Ndërkaq, është e pashmangshme që për mos suksesin e sistemit të drejtësisë në vend dhe të gjyqësorit në vecanti, faji për dështim t'i mbetet vetëm pushtetit ekzekutiv. Përkundrazi, pushteti gjyqësor në Kosovë për shkak të kompetencave kushtetuese dhe ligjore që posedon, është përgjegjësi kryesor për gjendjen aktuale në gjykatat dhe prokurorinë e Kosovës. Si rrjedhojë, këtu nevojitet një performancë më e madhe e gjyqtarëve dhe prokurorëve vendor dhe një asistencë më profesionale nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it. Në kuadër të kompetencave monitoruese, mentoruese dhe këshilluese të EULEX-it, komponenta gjyqësore e EULEX-it ka përgjegjësi të jetë më e zëshme jo vetëm në ushtrimin e mandatit ekzekutiv që kanë në veri të vendit dhe në krimet e rënda, por edhe në ofrimin e përvojës së tyre profesionale për reformimin e gjyqësorit të vendit.

Republika e Kosovës ende nuk ka hartuar politika për *mbrojtjen e dëshmitarëve*. Siguria e dëshmitarëve mbetet shqetësuese duke pasur parasysh një territor të vogël ku lehtë bëhet identifikimi i dëshmitarëve të mbrojtur. Ka pasur përpjekje për aprovimin e ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve bazuar në sistemet e ndryshme të disa shteteve perëndimore mirëpo aprovimi i një ligji të tillë do ta bënte të vështirë operacionalizimin e tij në mungesë të marrëveshjeve bilaterale me shtetet tjera. Për më shumë, kostoja e implementimit të saj do të ishte e pabërballueshme.

Janë bërë përpjekje për ngritjen e kapaciteteve në *shërbimin korrektues* të Kosovës. Mirëpo, investimet e deritashme kanë rezoluar vetëm në reformimin e qendrave ekzistuese të burgimit dhe paraburgimit. Mirëpo hapësirat e tanishme janë në shpërputhje me numrin e banorëve dhe rrjedhimisht ekziston nevoja e ndërtimit të burgjeve tjera e sidomos ngritja e një burgu të sigurisë së lartë sipas standardeve bashkëkohore. Është inicuar ndërtimi i burgut të sigurisë së lartë në Dyz të Podujevës mirëpo ky projekt pritet të vonoj së përfunduari në mungesë të fondeve. Në përgjithësi, rastet e ikjeve vitëve të fundit vënë në pikëpyetje sigurinë e burgjeve në Kosovë.²⁵

Sundimi i ligjit paraqet një ndër segmentet që në masë të madhe është ofruar *mbështetja nga partnerët dhe donatorët ndërkombëtar*. Mirëpo, hulumtimet e shumta kanë evidentuar mungesën e një koordinimi të donacioneve që do t'i kanalizonte përpjekjet e të gjithë akterëve të jashtëm në zhvillimin e sundimit të ligjit e në veçanti gjyqësorit. Një trajtim i veçant vlen t'i dedikohet *sundimit të ligjit në aspektin e shtrirjes territoriale*, përkatësisht zbatimit të saj. Kjo pjesë meriton të trajtohet në formë të ndarë nga zhvillimet e gjithmbarshme të sundimit të ligjit në Kosovë, pikërisht për shkak të realitetit faktik, gjegjësisht për shkak të mos zbatimit të sundimit të ligjit në veriun e Republikës së Kosovës. Në fakt, përkundër disa iniciativave të ndërmarrura nga Qeveria e Kosovës siç janë: hapja e zyrës për ofrimin e shërbime publike për qytetarët e vendit, hartimi i Strategjisë për veriun, shtimin e investimeve në veri, ndërrimin e disa komandantëve dhe disa iniciativave tjera

²⁵ Për më shumë shih <http://www.kosova-sot.info/politike/kosove/vjet-dy-arratisje-sivjet-asnje>

relevante, nuk është arritur asnjë rezultat i prekshëm që do ta konsideronte gjendjen aktuale më progresive sesa që ishte viteve të kaluara.

Për më tepër, nëse marrim në konsideratë incidentet të cilat gjatë këtij viti kanë shoqëruar veriun e vendit, dështimin në emërimin dhe ri-emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve të veriut të Mitrovicës, ri-organizimin dhe ngritjen e gatishmërisë së strukturave paralele të policisë dhe agjensioneve inteligjente të Serbisë, dështimin për rifunksionalizimin e Gjykatës së veriut, pamundësinë për të kthyer nën kontroll pikat doganore 1 dhe 31, dhe përgjithësisht dështimin për të vendosur rend dhe ligj, tregon një trend negativ të institucioneve të vendit jo vetëm për të forcuar Sundimin e ligjit por tregon një paaftësi institucionale për të kontrolluar këtë pjesë të vendit.

Për të analizuar paaftësinë e një dekade për vënien nën kontroll të veriut të vendit nën ombrellën e institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ekzistojnë skenare dhe arsyttime nga më të ndryshmet. Megjithatë, dështimi i institucioneve të vendit për të lëvizur pozitivisht në veri gjatë këtij viti, vjen si mungesë e një politike koherente karshi problemit të veriut. Mungesa e një politike të qartë se si mendohet të integrohet veriu i vendit ka bërë që veriut të mos ketë agjendë të qartë, të paktën në aspektin kohor dhe në metodën e integritit të saj. Këto dobësi vijnë si rezultat i zhvillimeve që kanë ndodhur në nivel ndërkombëtar dhe të mungesës së një plani të vërtet të institucioneve të vendit në lidhje me zbatimin praktik të Strategjisë së veriut.

Sa i përket zhvillimeve ndërkombëtare, mund të theksohet se pritjet për Opinionin Këshilldhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) kanë penguar institucionet e Kosovës që deri në Korrik të këtij viti, të ndihen komod për ndërmarrjen e veprimeve në veri. Dyshimet në përmbajtjen e mendimit të GJND-së e kanë pamundësuar një pozicionim të sigurtë për të hyrë në integritet të mëtutjeshme të veriut të vendit. Mirëpo, përkundër që Opinionin Këshilldhënës i GJND-së doli të jetë kryekëput në favor të Republikës së Kosovës, zërat që dolën pas këtij mendimi se veriu i vendit ka përgatitur një Deklaratë të Pavarësisë së kësaj pjese të vendit dhe së fundmi dyshimet që janë shfaqur se me Rezolutën e re të Asamblesë së Përgjithshme të GJND-së Bashkimi Evropian mund t'i ketë premtuar Serbisë mundësinë e bisedimeve për një status special për veriun e Kosovës, kanë kthyer përkushtimin dhe komoditetin e institucioneve të vendit në pikën zero.

Si rezultat i kësaj, përkundër që Strategjisë për Veriun i mungon një plan konkret i veprimit që konkretizon dhe zbërthen në veprime hapat që duhet të ndërmerren për implementimin e Strategjisë, lëvizjet në nivel ndërkombëtar, kanë bërë që gjendja në veri jo vetëm të mbetet në gjendjen zero, por edhe të ketë regres.

Përderisa, institucionet ndërkombëtare, kanë prezencë dhe ndikimin më të madh në veri të Kosovës, sigurisht se bashkë-përgjegjës të gjendjes ekzistente janë edhe KFOR-i, EULEX-i dhe mekanizmat tjerë të cilët direkt apo indirekt insistojnë në mirëmbajtjen e situatës e jo në zgjidhjen e problemit. Megjithatë, përkundër që Qeveria e Kosovës, ende mbetet e pafuqishme në veriun e Kosovës, duke qenë kompetente dhe përgjegjëse për shtrirjen e pushtetit në gjithë kufijtë e saj territorial, mban përgjegjësinë për dështimin në vënien e rendit dhe ligjit në këtë pjesë të territorit të saj.

Nga kjo mund të konstatohet se Sundimi i ligjit dhe sistemi i drejtësisë në vend nuk kanë pasur një zhvillim koherent në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Përderisa në pjesët tjera të vendit shohim të paktën një trend pozitiv të riorganizimit të sistemit të drejtësisë në vend, ajo që vazhdon të mbetet shqetësuese është mungesa e kontrollit dhe dështimin në vënien e sundimit të ligjit edhe në veriun e Kosovës.

2.6. Lufta kundër korrupsionit

Kosova ka shënuar progres të kufizuar në luftën e saj kundër korrupsionit. Korniza aktuale ligjore është një bazë solide për ta luftuar korrupsionin në instancat më të larta dhe më të ulëta qeverisëse. Deri më tani janë miratuar Ligji Anti-Korrupsion, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Ligji për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publikë. Megjithatë, për ta plotësuar paketën ligjore anti-korrupsion duhet të miratohen edhe ligjet e tjera: ligji anti-mafia, ligji mbi financimin e partive politike, ligji mbi shpëlarjen e parasë dhe ligji mbi konfiskimin e pasurisë.²⁶

Në Ligjin për Prokurim Publik, mund të vërehen të meta dhe mangësi të cilat janë adresuar edhe në raportet e progresit të Komisionit Evropian. Mangësitë më të mëdha kanë të bëjnë me rregullimin e procedurave si: procesin e kontraktimit, monitorimin e punëve, si dhe pagesave. Kualifikimet teknike dhe financiare të ofertuesve, për t'iu prezantuar autoritetit kontraktues nuk janë të detyrueshme me ligj.²⁷ Po ashtu mungojnë edhe dispozitat që e rregullojnë përcaktimin e varianteve. Ligji i ri për Prokurim Publik është miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 01.10.2010, megjithatë deputetë nuk i dhanë përkrahje propozimit të Qeverisë për ti mbajtur përgjegjës stafin më të lartë politik brenda kabinetit qeveritar (ministrat), me të cilën do të obligoheshin që të vendosin firmat e tyre në kontratat që kapin shifrën mbi 10.000 euro brenda ministrive të tyre.

Prokurimi një-burimor është rritur si formë e kontraktimit nga autoritetet. Kjo formë ka marrë një dimension edhe politik, sidomos pas ngjarjeve të verës, ose “rastit Limaj”. I rregulluar në mënyrë jo rigorozë, procesi i prokurimit një-burimor jep shumë hapësirë për manipulim të procesit të përzgjedhjes së ofertuesit të shërbimeve, furnizimit ose kryerjes së punëve. Shoqëria civile dhe mediat kanë hedhur dyshime mbi mënyrën e kontraktimit një-burimor.

Po ashtu, në ligj nuk ka mekanizma që e garantojnë mbrojtjen e “paralajmëruesve”²⁸ në raste të keqpërdorimeve në prokurim. Numri i trajnimeve të obliguara me ligj ka qenë i pamjaftueshëm gjatë vitit 2009. Janë mbajtur gjithsej 7 trajnime për anëtarët e Organit Shqyrtues të Prokurimit (jo të gjithë), përderisa ligji i obligon së paku dhjetë trajnime në vit për secilin zyrtar të prokurimit.²⁹ Si përmbledhje, çështja themelore që e pengon funksionimin e mirë të prokurimit publik është mos respektimi (shpesh edhe keq interpretimi) i Ligjit të Prokurimit Publik gjatë procesit të kontraktimit dhe monitorimit të kryerjes së punëve të furnizimit apo shërbimeve.

Qeveria e Kosovës ka realizuar progres të kufizuar në ndërmarrjen e aktiviteteve anti-korrupsion. Përgjatë kësaj periudhe kohore ka themeluar Task-Forcën Anti-Korrupsion, ka nxjerrë vendimin administrativ që për çdo tender që kalon shumën mbi 10.000 euro të nënshkruhet edhe nga ministri gjegjës, ka filluar procedurën e nxjerrjes së ligjit anti-mafia³⁰ dhe ka bërë shkarkimin e zv. ministrit të Ministrisë së Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës.³¹ Megjithëkëtë, këto aktivitete kanë qenë të pamjaftueshme për ta reduktuar nivelin e lartë të korrupsionit dhe shtrirjen e gjerë të tij në institucionet publike. Dhënia e tenderëve në mënyrë të parregullt, keqpërdorimi i autoritetit zyrtar dhe

²⁶ Një konstatim dhe rekomandim i tillë është dhënë në Raportin Përmbledhës nga Lëvizja FOL në tryezën “Lufta kundër korrupsionit: Progresi dhe Koordinimi Ndër-Institucional”, mbajtur me 24 Korrik, 2010

²⁷ Për më tepër, shih: *Ligji Nr. 2003/17 Për Prokurimin Publik në Kosovë. Neni 63, 64.1,4.*

²⁸ Whistleblowers

²⁹ Shih: Organi Shqyrtues i Prokurimit. Raporti Vjetor 2009. Fq. 7. Mund të gjendet tek: http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/Raporti_Shqip%20final_publication_mars31.pdf

³⁰ Një deklaram i tillë është dhënë nga kryeministri Thaci në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, mbajtur me 15 korrik 2010.

³¹ Fjala është për shkarkimin e ish zv. Ministrit Gjergj Dedaj, i cili është akuzuar për abuzim të parasë publike. Më gjerësisht shih Petrit COLLAKU – Kosovë: Zyrtari i shkarkuar pas disa ditëve emërimi, www.balkaninsight.com, 16 korrik 2010

abuzimi me paranë publike janë vetëm disa nga aferat korruptive që janë duke vazhduar ta shoqërojnë Qeverinë e Kosovës.³²

Kuvendi i Kosovës ka arritur përparim të vogël gjatë kësaj periudhe kohore. Ka miratuar Ligjin për Deklarimin, Kontrollin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve Publikë³³, ndërkaq ligjet e sipërpërmendura ende nuk janë miratuar nga ana e saj. Koha e pyetjeve parlamentare është shfrytëzuar në mënyrë solide për denoncimin e aferave korruptive nga ana e disa deputetëve, mirëpo mungesa e pranisë së ministrave është duke e pamundësuar dhe ngulfatur kohën e pyetjeve parlamentare. Kontrolli dhe dominimi i Qeverisë është duke vazhduar edhe më tutje mbi Kuvendin e Kosovës.

Sistemi Gjyqësor ka arritur progres të kufizuar në luftën kundër korrupsionit. E tëra që mund të nënvizohet gjatë vitit 2010 është zgjedhja e kryeprokurorit Ismet Kabashi, emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj, zgjidhja e rreth 30 lëndëve korruptive, angazhimi i Prokurorisë Speciale të Kosovës me rastin e arrestimit të Guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës dhe ndryshimi i Kodit Penal të Kosovës. Mirëpo, numri i lëndëve të pazgjidhura që kanë të bëjnë me shpërdorim të detyrës zyrtare, marrje të ryshfetit dhe dhënie të ryshfetit është vazhdimisht në rritje. Pikërisht mos-zgjidhja e këtyre lëndëve është duke treguar nivelin e dobët të funksionimit dhe efikasitetit të Gjyqësorit të Kosovës në luftimin e korrupsionit. Përpjekjet për reformimin e këtij pushteti kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2010.

Agjensioni Kundër Korrupsionit (AKK) ka shënuar progres të kënaqshëm në relacion me luftën kundër korrupsionit. Gjatë tërë vitit ka pranuar informata nga qytetarë dhe zyrtarë të ndryshëm në lidhje me afera korruptive në institucionet publike, ka denoncuar praktika abuzive, ka dërguar në Prokurori informata rreth zyrtarëve të involvuar në afera korruptive, si dhe suksesshëm ka përmblyllur procesin e deklarimit të pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publikë.³⁴ Agjensioni duhet të fuqizohet edhe më shumë, sepse roli dhe funksioni i saj është reduktuar vetëm në hetime administrative. Ana negative e AKK-së është treguar në drejtim të Konfliktit të Interesit. Shumë zyrtarë të përfshirë në konflikt të interesit janë shfajësuar nga ana e AKK-së, duke u krijuar komoditetin këtyre zyrtarëve të mbajnë shumë funksione publike. Miratimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka qenë njëri nga hapat që institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë si pjesë e strategjisë anti-korrupsion. Megjithatë, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk është koherent dhe ekziston kolizion mes neneve të vet ligjit. Kjo është vetëm njëra nga arsytet që ka sjellur deri tek mospërfillja e çështjes së konfliktit të interesit nga zyrtarët e lartë publik.³⁵

Dogana e Kosovës (DK) ka shënuar progres të kënaqshëm në raport me luftën kundër korrupsionit. Angazhimet e këtij institucioni kanë qenë në kontekst të hapjes dhe transparencës. Çdo herë kur janë paraqitur praktika abuzive janë marrë hapa të menjëhershëm për ndëshkimin e zyrtarëve të përfshirë në këto afera korruptive. Së fundmi është zvogëluar numri i rasteve me afera korruptive.

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) gjatë vitit 2010 ka treguar progres të kufizuar. Ka bastisur Ministrinë e Transportit, Postën e Kosovës dhe disa kompani e

³² Një gjendje të këtillë është dhënë nga Raportet e publikuara në vitin 2010: Raporti i Global Integrity, Raporti Amerikan mbi Politikën e Jashtme Amerikane, Raporti i Paralajmërimit të Hershëm të UNDP-së, Raporti i Freedom House dhe Raportet e publikuara nga organizatat e ndryshme jo-qeveritare (FOL, COHU dhe Iniciativa Kosovare për Stabilitet)

³³ Ky ligj është miratuar me 11 Shkurt 2010 dhe është dekretuar nga Presidenti Sejdiu me 2 Mars 2010

³⁴ Numri i zyrtarëve të cilët kanë qenë të obliguar ta deklarojnë pasurinë e tyre në vitin 2010 ka qenë 1560, ndërkaq vetëm 70 prej tyre nuk e kanë kryer këtë obligim, 4 nuk e plotësuar aplikacionin në formën e kërkuar dhe 1 zyrtar tjetër ka kërkuar që t'i mos publikohet pasuria e tij.

³⁵ Shih: Lëvizja Fol. *Parandalimi dhe luftimi i konfliktit të interesit në Kosovë. Shtator, 2010. Mund të gjendet tek: http://levizjafol.org/images/uploads/files/Parandalimi_dhe_luftimi_i_konfliktit_-_Analiz%C3%AB_e_shkurt%C3%ABr_politikash.pdf*

prona private të zyrtarëve të dyshuar për afera korruptive, si dhe ka arrestuar disa zyrtarë por që më pastaj janë liru. Përpjekjet e saj janë në drejtim të pastrimit të institucioneve të Republikës së Kosovës nga elementët korruptive. Megjithatë, duhet një angazhim dhe një qasje më konkrete në luftën kundërt korupsionit.

Shoqëria Civile ka shënuar progres të kënaqshëm në luftimin e korupsionit. Organizata të ndryshme jo-qeveritare që operojnë në Kosovë kanë ndërmarrë aktivitete dhe kanë publikuar Raporte të ndryshme në të cilat është pasqyruar puna dhe aktivitetet institucionale në luftë kundër korupsionit.

2.7. Politika e jashtme dhe shërbimi diplomatik

Ministria e Punëve të Jashtme ka shënuar të arritura minimale në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi, tetor 2009 - tetor 2010. Asnjë nga objektivat afatshkurta të deklaruara të MPJ-së nuk janë përmbushur në këtë periudhë, duke bërë që të shtohet dyshimi në kapacitetet e kësaj ministrie për të kryer detyrat e përcaktuara. Objektivat siç janë njohja e shtetit të Kosovës nga shumica e vendeve anëtare të OKB-së, njohja e shtetit të Kosovës nga të gjitha vendet e BE-së, prezantimi dhe përfaqësimi i Kosovës në shtetet nikoqire të sesioneve të ndryshme të organizatave ndërkombëtare apo ndërtimi i një shërbimi konsullor efektiv në të gjitha vendet në të cilat ka një prani domethënëse të mërgatës kosovare mbesin më tepër dëshira se sa objektiva drejt të cilave janë shënuar përparime të ndjeshme.

Në periudhën që është duke u vlerësuar, Kosovën e kanë njohur vetëm tetë shtete të reja, përkundër paralajmërimeve të shpeshta të ministrit të deritashëm të punëve të jashtme se njohjet e reja do të vijnë shpejtë. Ky rezultat bëhet edhe më dëshpërues kur kihet parasysh se njohjet nuk kanë ardhur as pas shpalljes së mendimit këshillëdhënës të GJND-së se shpallja e pavarësisë nga IPVQ-të nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Në këtë periudhë Kosova nuk është anëtarësuar në asnjë organizatë ndërkombëtare, edhe pse kjo është një prej objektivave të MPJ-së. Njohjet e fundit të tilla janë ato të qershorit 2009 kur Kosova u bë anëtare e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Kosova nuk ka marrë njohje as nga pesë shtetet anëtare të BE-së dhe rrjedhimisht as nuk ka arritur të vejë marrëdhënie kontraktuale me BE-në dhe të nisë procesin e rregullt të anëtarësimit në këtë organizatë. Vendet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën, por edhe vende të tjera, e arsyetonin vendimin e tyre për të mos e njohur një herë Kosovën me pritjen e mendimit këshillëdhënës të GJND-së. Për fat të keq, duket se MPJ-ja nuk ka qenë e përgatitur për fazën pas mendimit të GJND-së dhe e ka lëshuar rastin që të llobojë fuqishëm te vendet që nuk e kanë njohur Kosovën nga frika se kjo shkel parimet e të drejtës ndërkombëtare duke argumentuar se ky argument më nuk vlen dhe të kërkojë njohje nga këto shtete.

Kosova deri tani ka hapur 20 përfaqësi diplomatike, ambasada, në vende të ndryshme të botës. Por, shumë shpejtë janë shprehur pakënaqësi me punën e këtyre ambasadave dhe MPJ-ja kishte paralajmëruar se do të bënte një vlerësim të punës së ambasadorëve të Kosovës dhe t'i zëvendësonte ata që nuk kishin në nivel të detyrës. Në anën tjetër, ambasadorët e Kosovës ankohen vazhdimisht se nuk marrin instruksione të qarta nga MPJ se në çfarë duhet të angazhohen ata, praktikë kjo normale në punët e jashtme të vendeve. Ambasadat në vitin e parë janë marrë më tepër me çështjet logjistike e administrative por pas vitit të parë dhe në periudhën për të cilën flitet në këtë raport, përfaqësitë diplomatike të Kosovës kanë dështuar që të dallohen me punën e tyre. Dështim tjetër në punën e përfaqësive diplomatike është ndërtimi i shërbimit konsullor efektiv dhe ofrimi i shërbimeve konsullore për mërgatën kosovare. Edhe pse janë hapur disa shërbime konsullore, si ajo në Frankfurt të Gjermanisë, shërbimet që ofrohen aty nuk janë të plota dhe qytetarët e Kosovës ende nuk mund të pajisen me letërnjoftim apo pasaportë të plotë të Kosovës.

Edhe bashkëpunimi rajonal, ndonëse i deklaruar si objektiv, nuk ka shënuar ndonjë zhvillim të dukshëm në këtë periudhë të vlerësuar. E arritura më e madhe është samiti rajonal i vendeve fqinje të Kosovës, i organizuar nga Kryetari i Kosovës dhe i mbajtur në Prevallë të Prizrenit, e në të cilin morën pjesë kryetarët e Shqipërisë, Malit të zi, Maqedonisë dhe Kosovës por jo edhe ai i Serbisë. Vet MPJ-ja nuk ka shënuar ndonjë të arritur në thellimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit rajonal të Kosovës.

Ndër të arriturat e pakta që mund të përmenden janë paraqitjet e Ministrit të Jashtëm të Kosovës në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së gjatë raportimeve të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për gjendjen në Kosovë. Në këto paraqitje, Ministri i Jashtëm i Kosovës është dukur më bindes dhe më argumentues se përfaqësues të tjerë siç është ai i Serbisë. Megjithatë, këto raportime para Këshillit të Sigurimit të OKB-së nuk luajnë rol në procesin e njohjeve të Kosovës dhe nuk kanë ndihmuar që të shtohen njohjet për Kosovën.

3. PROGRESI EKONOMIK

3.1. Politikat ekonomike dhe stabiliteti makroekonomik

Qeveria e Republikës së Kosovës, më 30 prill 2010, aprovoi Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për periudhën 2011-2013, sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i cili parashihet dorëzimin e KASH-it në Kuvend jo më vonë se 30 prilli i vitit fiskal³⁶. KASH 2011-2013 është përpiluar si vazhdimësi e kornizave të viteve paraprake dhe përcakton analizat e mjedisit makroekonomik të Kosovës, e njëherazi prezanton një përmbledhje të burimeve të projektuara që janë në dispozicion për financimin e prioriteteve politike të Qeverisë. Megjithatë, pas shqyrtimit të Kornizës nga FMN-ja është bërë kërkesë për disa ndryshime në ligjet bazike financiare, ndaj dhe Qeveria e Kosovës u detyrua për të dytën herë në mbledhjen e 11 qershorit ta aprovoj KASH-in 2011-2013. Dërgesa e KASH-it në Kuvend pas 30 prillit, dhe ri-aprovimi i saj në qershor tregon se Qeveria e Kosovës ka ngecur në përmbushjen e afateve ligjore. Ky dokument paraqet sfidat me të cilat ballafaqohet ekonomia kosovare siç janë niveli shumë i ulët i eksportit në raport me importin, ulja e ndjeshme nga vitet paraprake të investimeve të huaja direkte, ekonomia joformale, niveli i lartë i papunësisë, mungesa e hartimit të politikave konkrete që do të bënin të mundur adresimin e këtyre problemeve dhe zgjidhjen e tyre, etj.

Ekonomia e Kosovës në vitin 2009 shënoi rritje reale të BPV (Bruto Produktit Vendor) prej 4,4% sipas MEF-it, e cila rezultoi për shkak të rritjes së shpenzimeve publike dhe rënies së çmimeve. Sipas KASH-it rritja mesatare reale e BPV-së gjatë viteve 2010-2013 pritet të jetë 5,4%, me nivelin më të lartë të rritjes prej 6,1% gjatë vitit 2011. Por të dhënat e FMN japin pasqyrë tjetër të rritjes së BPV. Sipas FMN, rritja e BPV në 2011 pritet të jetë 5,9% e jo 6,1% siç deklaroi MEF³⁷. Edhe pse përgjatë viteve Kosova ka pasur rritje të lehtë ekonomike, megjithatë ajo mbetet ndër vendet më të varfra në Evropë. Kosova do të duhej të kishte një rritje prej më së paku 10% për të arritur BPV për kokë banori të përafërt me shtetet fqinje si Shqipëria (me një rritje mesatare prej 5,5% vjetore) dhe Mali i zi (me një rritje mesatare prej 12% tashme për 5 vitet e fundit).

Tabela nr.1: Rritja reale e BPV në %

Vitet	Rritja sipas MEF	Rritja sipas FMN
2009	4,4	3,8
2010	4,8	4,6
2011	6,1	5,9
2012	5,8	n/a
2013	4,9	n/a

Burimi: MEF dhe FMN

Tabela nr 2. BPV në shtetet e Ballkanit

Shtetet	2005	2006	2007	2008	2009	BPV/kokë banori në \$
Shqipëria	5,5	5,0	6,0	6,5	2,2	4.016
Bosnja	5,0	6,2	6,8	5,4	-3,4	4.907
Kroacia	4,2	4,7	5,5	2,4	-5,8	15.637
Maqedonia	4,1	4,0	5,9	4,8	-0,7	4.650
Kosova	3,8	3,9	5,0	5,4	4	2.618
Mali i Zi	n/a	8,6	10,3	6,9	-7,0	7.925
Serbia	n/a	5,2	6,9	5,5	-2,9	6.713

Burimi: Banka Botërore

³⁶ Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë: Neni 19, Pika 19.1 “Sa më shpejt që të jetë praktike gjatë vitit fiskal 2008, dhe jo më vonë se deri me 30 Prill duke filluar nga viti fiskal 2009, Qeveria duhet t’ia dorëzoj Kuvendit Kornizën Afat Mesme dhe Shpenzimeve (KAMSH) për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme fiskale (“periudha Buxhetore e KAMSH”).

³⁷ Parashikimi i Ekonomisë Botërore, Tetor 2010, <http://www.imf.org/external/country/UVK/index.htm>

Pas rënies së Indeksit të Çmimeve të Konsumit (Consumer Price Index) gjatë vitit 2009 konsumi në sektorin publik shënoi rritje, përderisa ai në sektorin privat shënoi rënie të lehtë si pasojë e rënies së dërgesave nga diaspora (remitancat) për 5,5% dhe shtrëngimit të kredidhënies nga bankat komerciale (kreditë e reja për ekonomitë familjare u zvogëluan për 7,1% gjatë vitit 2009)³⁸. Pasqyra makroekonomike e MEF-it tregon se në vitin 2010 kemi rritje të IÇK-së, ku nëse krahasojmë periudhat Janar-Maj 2009 dhe Janar-Maj 2010 shohim një rritje prej 2,2%, e cila erdhi edhe si pasojë e rritjes së çmimeve të naftës dhe derivateve të saj për 17,8% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2009. Rritja e çmimeve të energjisë elektrike gjatë vitit 2009 ndikoi në rritjen e çmimit të prodhimit, dhe si pasojë u krijua varshmëri më e theksuar në importe, edhe pse gjatë vitit 2009 është vërejtur një zvogëlim i importeve për 0,4%, si pasojë e ndikimit të krizës financiare globale.

Bilanci buxhetor i vitit 2009 u përmyll me deficit prej 85.6 milion euro, krahasuar me deficitin buxhetor prej 8.1 milion eurove në vitin 2008, i ndikuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve kapitale dhe transfereve. Megjithatë raporti i Bankës Botërore³⁹ vlerëson se Qeveria e Kosovës vazhdon të mos i përmbahet Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, e kjo si pasojë e planifikimit të dobët, meqenëse buxheti vjetor nuk korrespondon me KASH-in.

ATK-ja raporton se të hyrat deri në shtator të vitit 2010 janë 221 milion euro prej të cilave vetëm nga mbledhja e taksave janë arkëtuar 158.7 milion euro, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009 ku kemi rritje në mbledhjen e taksave prej 14%. Të hyrat prej 158.7 milion euro janë kryesisht nga të mbledhurat e TVSH-së me 42,6%, tatimi për korporata me 19,3%, tatimi i mbajtur në burim me 18,8% dhe tatimi për bizneset individuale me 13,5%. Sistemi i taksave në Kosovë është shumë i varur nga të hyrat e doganave, e cila paraqet rrezik për fitimet dhe rritjen e mëtutjeshme të buxhetit. Në anën tjetër, shpenzimet e buxhetit kryesisht janë fokusuar në shpenzime kapitale (siç janë ndërtimet e rrugëve), megjithatë vërejtjet prej FMN-së dhe Bankës Botërore dëshmojnë se shpesh projektet madhore nuk janë të analizuara mirë, sidomos pa analizë të detajuar financiare.

Në përgjithësi, mund të themi se Kosova ka vazhduar të ketë rritje të BPV, megjithatë rritja prej 4,4% është shumë e vogël për të pasur një zhvillim të kënaqshëm ekonomik. Kosovës do t'i duhej një rritje prej më se paku 10% të BPV disa vite me radhë për të arritur në nivelin e zhvillimit ekonomik me vendet e rajonit. Të hyrat e buxhetit të Kosovës nga taksat këtë vit shënuan rritje për 14%, por kjo rritje mbetet e ndërvarur nga të hyrat e doganave. Ky fenomen është një ndër indikatorët kryesor që rrezikon stabilitetin e të hyrave në buxhetin e Kosovës në të ardhmen. Ndryshimi i Indeksit të Çmimit të Konsumit, e cila në vitin 2009 shënoi rënie, ndërsa në vitin 2010 shënoi rritje, mbetet gjithashtu jo-stabil. Nga këto indikatorë mund të shihet që Kosova edhe më tutje vazhdon të ketë një ekonomi jo-stabile, dhe njëherazi të jetë vendi më i varfër në Evropë.

3.2. Tregtia e Jashtme

Progresi ekonomik i Kosovës vlerësohet të jetë ndikuar në masë të madhe nga donacionet dhe ndihmat nga shtetet e huaja si dhe remitancave, të cilat nuk konsiderohen si burime të mjaftueshme të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, megjithatë ato vazhdojnë të mbeten financuesit e deficitit të lartë tregtar. Krahasuar me shtetet në tranzicion, Kosova karakterizohet me numër më të madh të migrantëve, të shpërngulur kryesisht në Evropën Perëndimore. Një në 4 amvisëritë në Kosovë ka së paku 1 anëtar që jeton jashtë Kosovës dhe remitancat janë vlerësuar si dëshmi e lidhshmërisë së migrantëve me familjet e tyre në Kosovë. Në vitet e pasluftës remitancat ishin mjaft stabile, duke përbërë 13-15% të BPV. Edhe

³⁸ Raporti Vjetor i BQK-së 2009 <http://bqk-kos.org/repository/docs/Raporti%20Vjetor%202009.pdf>

³⁹ Raporti i Bankës Botërore Nr. 53185-XK, "Kosova – Fuqizimi i potencialit të zhvillimit: Strategjitë, Politikat dhe Veprimet" – Memorandumi Ekonomik i një shteti, 29 prill 2010

pse remitancat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në uljen e varfërisë, ato nuk kanë ndikuar thelbësisht në zhvillimin e ekonomisë.

Sipas Entit të Statistikave të Kosovës deficiti tregtar në vitin 2009 arriti në 1.770,2 milion euro, apo thënë ndryshe 45% e BPV, përderisa deficiti tregtar i vitit 2008 ishte 1.729,7 milion euro. Totali i eksporteve në vitin 2009 ishte 165.3 milion euro, ndërsa importi 1.935,5 milion euro, e që qartas mund të shihet se eksporti mbulon importin për vetëm 8,5%. Në vitin 2008 eksporti vlerësohej me 198,5 milion euro, ndërsa importi me 1.928,2 milion euro, gjegjësisht 10,3% e BPV. Deri në gusht të viti 2010 eksporti vlerësohet të jetë 188,9 milion euro, ndërsa importi 1.352 milion euro. Kosova vazhdon edhe më tutje të mbështetet në kursimet e huaja për mbulesën e shpenzimeve të importit. Kështu në vitin 2009, importi, i nxitur nga investimet e larta publike dhe kërkesa për konsum, u rrit për 50% të vlerës së BPV. Për dallim nga vitet tjera eksportet këtë vit u kryesuan nga yndyrat bimore dhe shtazore, duke krijuar të ardhura prej 53 milion eurove (apo rritje për 227%), ndërsa makineritë dhe pajisjet e transportit shënuan rënie prej 27%, përcjellur me materialet e papërpunuara më një rënie prej 20% dhe duhani me 12% zvogëlim, ndërsa importet më të larta vazhduan të mbeten makineritë dhe pajisjet e transportit me një rritje të mëtutjeshme prej 20%. Sipas Entit të Statistikave të Kosovës, deri në gusht të vitit 2010 eksportet kryesohen nga ‘pijet dhe duhani’, ndërsa importet vazhdojnë edhe më tutje të kryesohen me kategorinë ‘makineritë dhe pajisjet transportuese’⁴⁰.

Raporti i Bankës Botërore “Të Bërit Biznes në vitin 2010”, vlerëson se Kosova performon negativisht në pikën “Tregtia përtej kufijve”, si pasojë e shpenzimeve të larta në eksport/import, distanca në portet kyçe, infrastruktura, etj. Edhe asistenca e huaj ka luajtur një rol të rëndësishëm në vitet e pasluftës, por që është në rënie e sipër. Në 3 vitet e fundit ajo mesatarisht përbën 8% të BPV.

Në vitin 2009 Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan rënie vjetore prej 20,4%, rënie kjo që po vazhdon tashmë 2 vite. Nga 13% e BPV sa konsiderohej në vitin 2007, ato në vitin 2008 shënuan rënie në 8,9%, ndërsa në vitin 2009 u vlerësuan vetëm 7,8% e BPV, e cila rrodhi si pasojë e krizës financiare globale, mos-zbatimit të marrëveshjes së CEFTA-s, si dhe ngadalësimit të procesit të privatizimit. Vlera e IHD-ve në Kosovë ishte 291,5 milion euro, përderisa IHD e kosovarëve në vendet e tjera arriti vlerën prej 10,6 milion euro (kryesisht për blerje të patundshmërisë në Shqipëri), prandaj vlera neto e IHD-ve në vitin 2009 vlerësohet 280,9 milion euro. Në tremujorin e parë të vitit 2010 IHD u vlerësua me 62,8 milionë euro, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2009 ishte një rritje prej 18,2%. Struktura e IHD-vë vazhdon të dominohet nga investimet kapitale me 72,6%, të cilat krahasuar me vitin 2008 shënuan rënie prej 4,8%. Kategoria e dytë përfaqësohet nga fitimet e pashpërndara me 20,1%, e cila në të kaluarën kishte pjesëmarrjen më të ulët të IHD-ve. Pjesa më e madhe e IHD-ve në Kosovës ka për origjinë vendet e BE-së, e kryesuar nga Gjermania dhe Sllovenia.

Nëse analizojmë Raportin e Bankës Botërore “Të Bërit Biznes” 2009 dhe 2010 vërehet se investitorët e huaj si edhe ata vendorë janë të shqetësuar për jo-efikasitet në administratën publike, rregulla komplekse, nivel të lartë korrupsioni, sistem të dobët gjyqësor, etj.

Tabela nr.3 Llojet e financimit në Kosovë (si % e BPV)

Lloji i financimit	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Investimet e Huaja Direkte	1,5	3,6	9,3	12,6	8,9	7,8
Remitancat	12,2	13,9	15,0	15,1	13,9	12,9
Eksporti	2,2	2,3	3,9	5,2	5,7	4,2
Asistenca Financiare	11,5	12,2	10,2	8,7	7,5	8,6
BPV (1,000 euro)	2.928	3.005	3.118	3.411	3.849	3.843

Burimi: Banka Botërore dhe FMN

⁴⁰ Enti i Statistikave të Kosovës: “Statistikat e tregtisë së jashtme 2009” dhe Buletinet e Tregtisë së Jashtme për muajt Janar – Gusht 2010

Për më tepër, raporti e radhit Kosovën në vendin e 171-të në botë sa i përket mbrojtjes së Investitorëve të huaj dhe ky indikator është më i ulët në vlerësimin e raportit të Bankës Botërore. Njëherazi kjo është dëshmi që investitorët e huaj nuk janë të interesuar të investojnë në Kosovë, prandaj dhe Qeveria e Kosovës së bashku me Agjensionin për Promovimin e Investimeve të Huaja duhet të ndërmarrin urgjentisht hapa konkret në përmirësimin e gjendjes aktuale. Në bazë të hulumtimeve të Bankës Botërore investitorët e huaj kanë deklaruar se kanë njohuri të vogla rreth Kosovës dhe se niveli i lartë i korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe sistemi i dobët gjyqësor janë faktorët kyç në largimin e tyre.

Doganat e Kosovës gjatë vitit 2009 kanë mbledhur 635.08 milion euro, e cila përfaqëson 98,44% të planit të MEF-it (45.1 milion euro) të nevojshme për financimin e Buxhetit të Kosovës. Krahasuar me të hyrat e vitit 2008, kemi një rritje prej 5% apo 30 milion euro më shumë (604.8 milion euro të hyra na vitin 2008). Indikatorët e rritjes të hyrave ishin menaxhimi i riskut, gjegjësisht aplikimi i kontroleve selektive dhe fokusimi i resurseve tek dërgesat me rrezik të lartë; normat e reja të aplikuara të TVSH-së; vlerësimi më i mirë i mallrave; dhe rritja e të hyrave nga taksat e akcizës për pije alkoolike dhe joalkoolike krahasuar me vitin 2008.

Tabela nr. 4 Të hyrat e Doganave të Kosovës

Lloje e të hyrave	2007	2008	2009
Taksat doganore	80.285.075,96	93.293.782,80	98.312.002,42
TVSH	252.464.425,68	304.715.800,56	327.661.731,58
Akciza	189.507.811,47	203.314.511,68	206.917.391,8
Të tjera	4.721.910,83	3.544.518,59	2.147.175,26
Totali	526.979.223,94	604.868.613,63	635.038.300,34

Burimi: Doganat e Kosovës

Gjatë këtij viti Dogana e Kosovës ka zbuluar 641 kundërvajtje doganore, prej tyre a) gjoba dhe aktvendime të shqiptuara për inkasim në vlerë prej 4 milion euro dhe b) vlera e mallrave të konfiskuara në vlerë prej 1.2 milion euro. Megjithatë Doganat e Kosovës ende vazhdojnë të mos kenë qasje në dy portat kufitare në veriun e Kosovës, i cili cilësohet si vendi me aktivitetet më të larta të kontrabandimit dhe e cila i shkakton humbje të mëdha doganës, respektivisht buxhetit të Kosovës. Gjithashtu, rënia prej 38% e çmimit të naftës së importuar ka ndikuar në vjeljen e më pak të hyrave nga TVSH-ja në vitin 2009 për 5% krahasuar me vitin 2008.

Sipas Raportit Vjetor të Doganave të Kosovës, vlera e mallrave të importuara gjatë vitit 2009 ishte 1.838 miliardë euro, ngjashëm me atë të vitit 2008 në vlerë prej 1,840 miliardë euro, ndërsa vlera e eksportit të rregullt dhe ri-eksportit për vitin 2009 ishte 187,4 milion euro, krahasuar me 231,9 milion euro në vitin 2008. Sipas Doganave vendet prej të cilave Kosova më së shumti importon vazhdojnë të mbeten në top-listë; Maqedonia me 288 milion euro vlerë (e që krahasuar me vitin 2008 shënon një rënie prej 16%), Gjermania me 237 milion euro vlerë (e që krahasuar me vitin 2008 shënon rritje prej 21%), Serbia me 207 milion euro vlerë (ngjashëm me atë të vitit 2008), Turqia me 137 milion euro vlerë (rritje prej 9% krahasuar me vitin 2008) dhe Kina me 127 milion euro vlerë (rritje prej 6% krahasuar me vitin 2008). Krahasuar me vitin 2008 rënia më e madhe e importit ka ndodhur nga Ukraina prej 48% rënie, ndërsa rritja më e madhe e eksportit ka ndodhur nga Holanda me 55%. Sa i përket eksportit, vendet tek të cilat Kosova eksporton vazhdojnë të mbeten po ato të njëjtat. Shqipëria kryeson me 17 milion euro (një rritje për 13% krahasuar me vitin 2008), Maqedonia në vlerë prej 13,9 milion euro (një rrënie prej 17%), Gjermania në vlerë prej 11,4 milion euro (një rritje e madhe për 163% krahasuar me vitin 2008) dhe Zvicra në vlerë prej 10 milion eurove (rritje prej 44%). Rritje të eksportit ka pasur me Kroacinë (126% rritje) dhe me Austrinë (111% rritje krahasuar me vitin 2008), ndërsa rënie drastike në eksport ka pasur me Bosnjën, prej 81% po që në vlera monetare nënkupton mbi 3 milion euro humbje krahasuar me vitin 2008.

Në përgjithësi, viti 2009 u përmbyll me një bilanc edhe më negativ tregtar krahasuar me vitin paraprak. Deficiti tregtar u rrit për 40,5 milion euro, si pasojë e rritjes së importit dhe zvogëlimit të eksporti. Për më tepër asistencë e huaj, së bashku me IHD shënuan rënie të mëtutjeshme. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet urgjentisht të ndërmarr hapa në parandalimin e situatës së krijuar, meqenëse Kosova vazhdon të perceptohet si shtet me korrupsion të lartë, procedura jo-efikase dhe burokratike në administratën publike, sistem i dobët gjyqësor etj. I vetmi përmirësim në këtë fushë ishte rritja e të hyrave nga doganat, por e cila erdhi si rrjedhojë e normave të reja të TVSh-së dhe rregullave të reja të aplikuar në dogana.

3.3. Zhvillimi i sektorit financiar

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës edhe gjatë vitit 2009 vazhdoi me aktivitetet e saj administrative, financiare dhe menaxhuese, siç e parasheh Ligji Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës⁴¹. Mungesa e valutës shtetërore është duke ndikuar edhe në hartimin e politikave monetare nga ana e BQK-së edhe pse ajo vazhdon të luaj rol in e monitorueses dhe manaxhueses së sektorit financiar. Sektori financiar gjatë vitit 2009 mbeti edhe më tutje stabil edhe pse kriza financiare kishte kapluar mbarë botën, por meqë Kosova ka një ekonomi të pa-globalizuar dhe të varur nga investimet publike dhe financiare, ajo mbeti më pak e prekur nga kriza.

Sektori financiar i Kosovës gjatë vitit 2009 u rrit për 24,2%, duke arritur vlerën e përgjithshme të aseteve prej 2,8 miliardë euro, ku pjesën më të madhe (78,6%) e përbën sektori bankar, edhe pse krahasuar me vitet e kaluara kjo është një pjesëmarrje më e ulët. Në anën tjetër, fondet pensionale menaxhojnë 13,6% të sektorit financiar, përderisa pjesa tjetër prej 7,8% përbëhet nga institucionet mikrofinanciare me 4,7%, kompanitë e sigurimeve me 2,9% dhe ndihmësve financiar me 0,2%. Deri në qershor të vitit 2010 asetet e sektorit financiar arritën vlerën 2,9 miliard euro, e që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2009 kemi një rritje prej 0,5 miliardë euro. Krahasuar me vitin 2008 numri i bankave komerciale (8), kompanitë e sigurimeve (11) dhe fondet pensionale (2) mbeten po ato të njëjtat, ndërsa si risi kemi hyrjen në tregun financiar të 2 institucioneve të reja mikrofinanciare.

Vlera e aseteve të jashtme vazhdon të jetë e lartë, duke përbërë kështu 43,6% të BPV në vitin 2009, ku pjesa më e madhe e tyre (44,7%) është e investuar në formë të depozitave apo edhe në letrat me vlerë (35,6%). Viti 2009 u karakterizua edhe me rritjen prej 18% të vlerës së kërkesës ndaj sektorit të jashtëm (2,04 miliardë euro). Sektori financiar bartë detyrime ndaj sektorit fiskal, të cilat përbëhen në formë të depozitave të qeverisë, e që në vitin 2009 shënuan rritje vjetore prej 2,9% duke arritur kështu vlerën prej 846,3 milionë euro.

Sektori bankar dhe më tutje vazhdon të jetë i dominuar nga pronësitë e huaja, të cilët menaxhojnë 91,5% të aseteve. Gjatë vitit 2009 shkalla e koncentrimit mbeti e lartë, ku 3 bankat menaxhuan 81% të gjithë aseteve, edhe pse krahasuar me vitet e kaluara kjo shënon një trend negativ. Në vitin 2009 është vërejtur një ngadalësim në rritjen e numrit të degëve dhe nëndegëve, nga 287 sa ishin në vitin 2008 u rritën në vetëm 292, ndërsa karakteristikë është se në vitin 2009 u shënuar rënie në numrin e të punësuarve, ku nga 3.607 të punësuar në banka numri u zvogëluar në 3.444 në vitin 2009. Edhe trendi i rritjes së kredidhënies tregoi një normë të ulët krahasuar me vitet e kaluara ku norma e rritjes në vitin 2009 ishte 8,9% krahasuar me vitin 2008 prej 32,7%. Vlera mesatare e kredive të reja të lëshuara për një muaj ishte 52,5 milion euro në vitin 2009, krahasuar me 57,8 milion euro në vitin 2008. Kreditë për ekonomitë familjare u ndikuan në masë më të vogël, duke shënuar rritje prej 22,3%, ndërsa kreditë për ndërmarrjet ishin ato më të ndikuarat të cilat shënuan rënie vjetore për 4,6%, edhe pse struktura e kredive gjatë vitit 2009 u dominua nga kreditë për ndërmarrjet. Kështu pjesa më e madhe e kredive u absorbua nga sektori i tregtisë (56,4% e kredive për ndërmarrje),

⁴¹ Ligji Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. <http://bqk-kos.org/repository/docs/Ligji%20per%20BQK-ne.pdf>

përderisa sektori me pjesëmarrje më të ultë vazhdon të jetë sektori i bujqësisë me vetëm 4%. Ndërsa sa i përket maturitetit trendi i kredihënies vazhdoi të mbetet po ai i njëjti, ku pjesa më e madhe e kredive përbëhet nga kreditë me afat maturiteti mbi 2 vjet (70%). Sa i përket depozitave ato gjatë vitit 2009 shënuan rritje vjetore prej 21% duke arritur vlerën prej 1,74 miliard euro. Pjesa më e madhe e depozitave të sektorit bankar përbëhet nga depozitat e ekonomive familjare (60%), përderisa depozitat e ndërmarrjeve private përbëjnë 15,3%. Viti 2009 në sektorin bankar u karakterizua me rritje të lehtë në normat e interesit në kredi (0,3 pp.) dhe rënie në normat e interesit në depozita (0,44 pp.). Viti 2009 u përmbyll më një profit neto prej 29,6 milion euro në sektorin bankar të Kosovës, e cila është 30,5% më e ulët krahasuar me profitin e vitit 2008.

Në sektorin e kompanive të sigurimit stabiliteti vazhdoi edhe përgjatë vitit 2009. Numri mbeti i ngjashëm më atë të vitit 2008, pra 11 kompani, 10 prej të cilëve ushtrojnë veprimtarinë në sigurimet jo-jetë, dhe 1 në sigurimet e jetës. Asetet në sektorin e sigurimeve u rritën për 5% duke arritur vlerën prej 88,1 milion euro, të cilat dominohen nga depozitat (63,7%). Në vitin 2009, numri i polisave të shitura arriti numrin prej 511.000 (7,4% rritje), ndërsa vlera e primeve të pranuar u rrit për 20,2% (66,7 milion euro vlerë). Në vitin 2009, kompanitë e sigurimeve paguan shumën e dëmeve prej 18,8 milion euro, e cila paraqet rritje vjetore prej 6,5%, por meqenëse vlera e primeve shënoi rritje të theksuar raporti mes tyre shënoi rrënjë prej 31,3% krahasuar më vitin 2008.

Sistemi pensional i Kosovës vazhdon të mbetet i bazuar në 3 shtylla, e para e cila menaxhohet nga qeveria për të gjithë personat mbi moshën 65 vjeç, 2. Trusti (TKPK) dhe 3. Fondi Slloven-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Vlera e aseteve të sistemit pensional të Kosovës në vitin 2009 paraqet 10% të BPV. Performanca e Trustit gjatë vitit 2009 ishte e mirë krahasuar me atë të vitit 2008, kthimi në mjetet e investuara ishte 14,1% (12.2008-12.2009). Vlera e aksionit të trustit në fund të vitit arriti në rreth 1,0 euro.

Viti 2009 u karakterizua me arrestimin e guvernatorit të Bankës Qendrore, nga ana e forcave të rendit dhe prokurorisë speciale, por kjo situatë nuk ndikoi në stabilitetin dhe menaxhimin e këtij institucioni mjaft të rëndësishëm. Dy muaj pas ditës së arrestimit, institucionet relevante, gjegjësisht Kuvendi ende nuk e ka suspenduar guvernatorin nga detyra. Në bazë të Ligjit të ri për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të miratuar me 27 korrik 2010, Presidenti e ka autoritetin ta suspendojë guvernatorin e BQK-së dhe pastaj ky vendim duhet të miratohet edhe nga Kuvendi si organ mbikëqyrës i BQK-së. Megjithatë, para marrjes së këtyre masave kushtetuese dhe ligjore, guvernatori i BQK-së kërkoi vet nga ana e Bordit Drejtues të suspendohet nga detyra deri në përfundimin e hetimeve ndaj akuzave që u janë ngritur nga organet e drejtësisë.

Sektori financiar në përgjithësi shënoi një rritje të aseteve prej 24,2%, trend ky që po vazhdon edhe në 6 mujorin e parë të vitit 2010. Megjithatë viti 2009 u karakterizua me trend më të vogël të rritjes tek bankat. Vitit 2009 shënoi një trend të vogël të rritjes së kredive të reja si dhe hapjes së degëve dhe nën-degëve të bankave, madje viti 2009 shënoi rënie të numrit të të punësuarve në këtë sektor. Sektori bankar u cilësua gjithashtu me rritje të lehtë të normave të interesit për kredi dhe zvogëlim të normave të interesit në depozita. Në anën tjetër, sektori i kompanive të sigurimit dhe ai personal ishin mjaft stabile, madje gjendja e tyre krahasuar me vitin 2008 është përmirësuar. Por, duke e ditur varshmërinë e qytetarëve në banka, mund të themi se viti 2009 ishte viti më i vështirë për kosovarët.

3.4. Hyrjet dhe daljet në treg të ndërmarrjeve

Sektori privat në Kosovë është mjaft i dobët, ku shumica e të punësuarve punojnë në bizneset e vogla dhe atë kryesisht në sektorët e vlerave të ulëta. Shumica e bizneseve nuk gëzojnë rritje prandaj dhe oferta e punësimit është shumë e ulët, gjë që shkakton mbajtjen e nivelit kaq të lartë të papunësisë.

Sipas Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve, në Kosovë deri në vitin 2009 ishin 89.941 biznese individuale të regjistruara, përderisa maji i vitit 2010 raportohet me 99.647 biznese, ndërsa numri vjetor i ndërmarrjeve që shuhet tashmë 3 vite është rreth 1.000 ndërmarrje. Megjithatë, një numër i madh i firmave operojnë në sektorin jo-formal, të cilët edhe më tutje dëmtojnë ambientin e bizneseve dhe vetë produktivitetin e tyre. Një ndër bizneset e vogla që janë në rritje janë lojërat e fatit që shihet si karakteristikë e vendeve të varfra. Vetëm deri në gjysmë-vjetorin e parë të vitit 2010 janë 7 subjekte të reja të licencuara dhe 72 njësi të reja të licencuara, të cilat gjeneruan 1.03 milion euro të hyra për ATK-ën në formë të taksave dhe 20.000 euro në formë të hyra në formë të gjobave.

Sipas ATK-së deri në shtator të vitit 2010 numri i bizneseve të cilat janë pajisur me numër fiskal është 61.114, prej tyre 55.193 janë dhënë për biznese ndërsa 5.921 për persona fizik. Deri në shtator të vitit 2010 janë fiskalizuar 4.045 tatimpagues (B-MVM) me gjithsej 5.538 pajisje elektronike fiskale. Qeveria e Republikës së Kosovës ka shpallur kompetente 2 kompani të vetme për shitjen e pajisjeve elektronike fiskale, kompanitë Geokos dhe Dukagjini. Pas ankesave të bizneseve për çmime të larta ta arkave fiskale, Komisioni Kosovar i Konkurrencës filloi hetimin 3 mujor në të dyja kompanitë e licencuara për shitjen, instalimin dhe mirëmbajtjen pajisjeve elektronike fiskale, të cilave pas analizave u janë shqiptuar masat e ndëshkimit administrativ në vlerë prej 100.000 euro për secilën kompani. Geokos është ndëshkuar për krijimin e pozitës monopolizuese dhe dominuese në treg dhe abuzim të kësaj pozite, ndërsa Dukagjini për praktikën bashkëpunuese me Geokos në krijimin e këtij monopoli.

Kosova sipas raportit të Bankës Botërore “Të bërit Biznes 2010” zë vendin e 113 në botë për lehtësirat e të bërit biznes. Ky vlerësim njëherazi tregon vështirësitë me të cilat përballen bizneset që dëshirojnë të operojnë në Kosovë. Kështu për të hapur një biznes të ri në Kosovë nevojitet të kalohet nëpër 9 procedura të cilat zgjasin rreth 51 ditë punë dhe kushtojnë rreth 43% të të hyrave/kokë banori. Këto procedura të gjata dhe të kushtueshme shpesh hapin rrugë për korrupsion apo edhe për ekonomi jo-formale. Për më tepër, leja për ndërtim është një faktor edhe më dëmtues meqë për të nevojitet të kalohet në 21 procedura burokratike që zgjasin rreth 320 ditë pune dhe shpenzimet sillen rreth 1.291% të të hyrave/kokë banori. Kosova është në top 8 vendet me kushte më të këqija sa i përket leje-ndërtimeve, e dihet shumë mirë se sektori i ndërtimit në Kosovë është ndër elementet kyçe të ekonomisë. Përderisa sa u përket lehtësirave për mbylljen e bizneseve Kosova radhitet në vendin e 28 në botë. Mungesa e ligjit të punës në anën tjetër u lejon ndërmarrjeve të jenë shumë fleksibile sa u përket punëtorëve, prandaj dhe Kosova radhitet ndër top vendet e 50-ta për sa i përket lehtësirave për punësim dhe shkëputje të kontratës, e cila shikuar në aspektin e punëtorëve i lë ata të pambrojtur.

Në përgjithësi, sektori privat në Kosovë vazhdon të mbetet ende i pazhvilluar në nivelin e duhur. Afro 10.000 biznese të reja regjistrohen në vit por shumica prej tyre janë të kategorisë ‘vetë-punësim’, të cilat nuk ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, e as në hapjen e vende të punës, madje për më tepër shumë prej tyre operojnë në sektorin jo-formal. Qeveria e Kosovës, si metodë për luftimin e sektorit jo-formal por edhe luftimit të korrupsionit në vitin 2009 filloi zbatimin e projektit të instalimit të arkave fiskale, i cili proces u karakterizua me probleme të shumta. Vetë Qeveria e Kosovës duke u dhënë leje vetëm 2 kompanive hapi rrugë për monopolizimin e tregut, e cila solli në rritjen e mëtutjeshme të pakënaqësisë së bizneseve për shkak të çmimit tejet të lartë. Vlen të theksohet se raporti i Bankës Botërore “Të bërit biznes në vitin 2010” krahasuar me atë të vitit 2009 e vendos Kosovën në pozitë më të ultë, që dëshmon regres ekonomik.

4. STANDARDET EVROPIANE

4.1. Prokurimi publik

Pas akuzave të shumta për korrupsion dhe pas bastisjeve të EULEX-it në disa dikastere qeveritare, Qeveria e Kosovës ka marrë masa për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurim Publik. Hapi i parë për këtë u ndërmor në muajin maj, kur Qeveria miratoi Udhëzimin Administrativ për Nënshkrimin e Kontratave Publike me Vlerë të Mesme dhe të Madhe. Ky udhëzim administrativ parasheh që përveç zyrtarit të prokurimit, i cili me Ligjin për Prokurim Publik ka përgjegjësinë dhe të drejtën për nënshkrimin e kontratave, tani e tutje kontratat me vlerë mbi 10.000 Euro duhet të nënshkruhen edhe nga sekretari i ministrisë dhe ministri (apo kryetari i komunës, në rastin e komunave). Kjo formë e ndryshimit të ligjit nuk është konform rregullave ligjore, pasi që me akt nënligjor u ndryshua përmbajtja e vetë Ligjit. Ky udhëzim administrativ ka hyrë në fuqi më 30 qershor 2010.⁴²

Mirëpo, më 7 korrik 2010, Qeveria e Kosovës miratoi edhe një herë Projektligjin për Prokurim Publik. Kësaj radhe, ndryshimet e kërkuara dy muaj më parë përmes udhëzimit administrativ, janë inkorporuar në Projektligj. Neni 26.2 i Projektligjit bën fjalë për nënshkrimin e kontratave, ku: “Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit kontratat me vlerë të mesme dhe të mëdha të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen ne emër te autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, gjegjësisht Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik.” Projektligji është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa kontratat me vlerë të mesme dhe të lartë nënshkruhen sipas udhëzimit administrativ 02/2010.

Në përgjithësi, Qeveria e Kosovës ka krijuar paqartësi më të mëdha sa i përket Ligjit të Prokurimit Publik dhe nënshkrimit të kontratave. Me obligimin e ministrave, gjegjësisht zyrtarëve tjerë kryesor administrativ, i jepet rëndësi e barabartë zyrtarëve profesional të Prokurimit me përfaqësuesit politik. Kjo mënyrë e nënshkrimit të kontratave pritet që të zvarrit edhe më tej procedurat tenderuese.

Në maj 2010, Ilir Rama ka dhënë dorëheqje nga detyra e drejtorit të përkohshëm Bordit të Agjensionit të Prokurimit Publik. Ilir Rama ishte emëruar drejtor i përkohshëm i APP në tetor të 2010. Emërimi i tij nga Qeveria për një periudhë 19 mujore ishte në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik. Mirëpo, Qeveria e Kosovës ka përsëritur të njëjtin gabim, ku më 2 korrik 2010 sërish ka emëruar një person tjetër për drejtor të përkohshëm ekzekutiv të APP, duke anashkaluar Kuvendin e Kosovës.⁴³

Më 8 korrik 2010 Kuvendi i Kosovës ka emëruar përbërjen e re të Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP). Përbërja e re e bordit prej tre anëtarësh është cilësuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës si jo kompetente dhe e politizuar.⁴⁴

Sipas Raportit Vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për 2009, janë shtuar ankesat e operatorëve ekonomik sa i përket procedurave të prokurimit publik. Gjatë 2009 OSHP ka pranuar 457 ankesa të operatorëve ekonomik kundër vendimeve të autoriteteve kontraktuese, apo 61% më shumë ankesa se sa në vitin 2008. Ankesat janë kryesisht në procedurat tenderuese në vlerë të lartë (127 milion euro), kurse më pak ankesa ka për tenderët me vlerë të mesme dhe të ulët.⁴⁵ Edhe pse OSHP vlerëson se rritja e ankesave vie si rezultat i ngritjes së

⁴²Udhëzimi Administrativ gjendet e faqen zyrtare të KRPP në internet <http://www.ks-gov.net/krpp/PageFiles/File/udhezimi%20administrativ%2002-2010.pdf> (shfletuar së fundmi më 13 tetor 2010).

⁴³ Neni 92.3 i Ligjit për Prokurim Publik (me ndryshimet dhe plotësimet e datës 8 shkurt 2007) Drejtori propozohet nga Qeveria dhe emërohet nga Kuvendi.

⁴⁴ Kryetari i Bordit të KRPP të emëruar më 8 korrik 2007 ka qenë kryetar i degës së PDK në Suharekë si dhe anëtar i Kuvendit Komunal të Suharekës nga kjo parti. Ky fakt është potencuar edhe nga deputeti Haki Shatri në seancën e Kuvendit të Kosovës të datës 8 korrik 2007.

⁴⁵ Raporti Vjetor 2009 i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, dërguar Kuvendit të Kosovës më 25 shkurt 2010 (<http://www.ks-gov.net/krpp/PageFiles/File/udhezimi%20administrativ%2002-2010.pdf>)

besueshmërisë ndaj OSHP, ky numër aq i madh i ankesave mund të jetë edhe rezultat i vendimeve jo të drejta të autoriteteve kontraktuese.

Në përgjithësi, institucionet e Kosovës nuk kanë marrë hapa konkret në përmirësimin e gjendjes në prokurimin publik. Nuk është vendosur ende baza ligjore adekuate në këtë sferë. Ndryshimi i Ligjit për Prokurimin Publik përmes udhëzimeve administrative është i kundërligjshëm dhe përzierje në kompetencat ligjvënëse të Kuvendit të Kosovës. Qeveria e Kosovës ende nuk i ka propozuar Kuvendit kandidatin për drejtor ekzekutiv të APP, por që nga tetori i 2008 ky post ushtrohet nga drejtori i përkohshëm. Numri i ankesave të operatorëve ekonomik është rritur 61% në krahasim me një vit më parë. Projektligji i ri i Prokurimit Publik, i cili është miratuar në Kuvend më 1 tetor 2010 (por që ende nuk ka hyrë në fuqi), i jep kompetenca shtesë KRPP në mbikëqyrjen e kryerjes së kontratave publike. Këto kompetenca shtesë kërkojnë edhe angazhim të stafit shtesë. Bordi i ri i KRPP është emëruar në korrik 2007, mirëpo anëtarët e rinj janë kritikuar si jo profesional dhe politik.

4.2. Punësimi dhe Politikat Sociale

Për herë të tretë brenda katër viteve, Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin e Punës. Ky ligj pritet të zëvendësoj Rregulloren e UNMIK-ut për Ligjin Themelor të Punës, e cila është në fuqi që nga viti 2001, mirëpo nuk ka gjetur zbatim në praktikë. Projektligji i Punës është dërguar në Kuvend në maj të 2010. Në përmbajtjen e projektligjit kanë reaguar organizatat e punëtorëve dhe shoqëria civile, sidomos për nenin 48, i cili u jep të drejtë grave vetëm 12 javë pushim lehonie. Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka miratuar këtë ligj në leximin e dytë (deri më 14 tetor 2010). Sipas anëtarëve të grupit punues në Projektligjin e Punës, pritet që ky projektligj të pësoj ndryshime rrënjësore, e që pritet që të rrisin koston e zbatimit të Ligjit të Punës. Sipas deklaratës së ndikimit financiar të hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF), Ligji i Punës do të kushtoj Buxhetit të Kosovës 1.8 milion Euro në vit, nëse miratohet në formën që është dërguar në Kuvend. Kjo vlerë është paraparë edhe me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2011-2013.

Edhe në rast të aprovimit të tij, Ligji i Punës nuk pritet të hyjë në fuqi para janarit të 2011. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Ligjit të Punës përballen me probleme të shumta. Nuk ka gjykatë të posaçme për zgjidhjen e kontesteve nga marrëdhëniet e punës. Një gjykatë e tillë nuk parashihet as me strukturën e re organizative që pritet të hyjë në fuqi nga viti 2013, sipas Ligjit për Gjykatat. Kur merret parasysh numri i lartë i lëndëve të pazgjidhura, mos ekzistimi i një gjykate të posaçme për zgjidhjen e kontesteve nga marrëdhënia e punës ose gjykatës të specializuar të kësaj fushe, dekurajon qytetarët për t'iu drejtuar gjykatave në rast të kontesteve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës që zgjidh kontestet nga marrëdhënia e punës në kuadër të shërbimit civil të Kosovës është treguar i ngathët në punën e tij. Në shumë raste të kontesteve në të cilat ka intervenuar KPM, vendimet janë vonuar me vite të tëra. Zgjatje e vendimmarrjes nga ana e KPM i ka kushtuar buxhetit të Kosovës në shumë raste.

Edhe Inspektorati i Punës, i cili funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, përballen me mungesa të shumta. Në tërë territorin e Kosovës janë të angazhuar 49 inspektorë të punës. Në pesë komuna të Kosovës nuk ka të angazhuar fare inspektorë të punës. Sipas të dhënave më të fundit të Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve deri në maj të 2010 kanë qenë të regjistruara 99.647 biznese. Në vit, sipas ligjit, çdo inspektor i duhet që të inspektoj 2033 biznese të regjistruara. Jo të gjitha nga bizneset e regjistruara janë funksionale, mirëpo një nga detyrat e inspektorëve të punës është edhe identifikimi i bizneseve që nuk janë funksionale dhe që nuk janë çregjistruar si të tilla. Përveç mungesës së stafit, inspektorët e punës përballen edhe me mungesë të automjeteve, zyrave dhe pagave të ulëta. Si pasojë e këtyre faktorëve, nuk ka gjetur zbatim praktik as Ligji për Sigurinë në Punë, Mbrojtje të Shëndetit dhe Ambient të Punës.

Shkalla e papunësisë në Kosovë edhe më tutje mbetet e lartë. Sipas të dhënave më të fundit, papunësia në Kosovë gjatë 2009 ishte 45.4%, një ulje prej 2.1% në krahasim me 2008 (47.5%).⁴⁶ Shkalla e papunësisë është më e madhe tek femrat (56.4%) dhe tek grupmoshat e reja 15-24 vjeçare (73%). Edhe më tutje, Qeveria (sektori publik) mbetet punëdhënësi më i madh në Kosovë me 74.910 të punësuar.⁴⁷ Punësimi më i madh gjatë 2009 është bërë në degën e tregtisë (17.4%), pasuar nga arsimiti (13.4%), prodhimi (9.9%), administrata (9.8%), etj.⁴⁸

Numri i të papunëve të regjistruar deri në fund të gushtit 2010 në Qendrat Komunale të Punësimit është 335.347 punëkërkues, nga 338.407 sa ishin në të njëjtën periudhë të 2009. Punësimi me ndërmjetësim të zyreve të punësimit është shumë i ulët apo vetëm 2.14% në vit.⁴⁹ Dhe kjo shkallë e ulët e punësimit me ndërmjetësim të zyreve të punësimit dekurajon të papunët që të regjistrohen si punëkërkues në Qendrat e Punësimit. Niveli i papunësisë në Kosovë është më i larti në Evropë, ndërsa shkalla e punësimit mbetet më e ulëta në Evropë.

Këshilli Kosovar Trepalësh ka ndërruar emërtim në 2009 në Këshilli Ekonomiko-Social. Ky ndryshim emërtimi është bërë me arsyetim për të harmonizuar emërtimin me standardet e BE. Në korrik 2010 Qeveria ka miratuar Projektligjin për KES, i cili ende nuk është miratuar në Kuvendin e Kosovës. KES ka qenë jo funksional për një kohë të gjatë. Arsye për këtë ka qenë vendimi i Qeverisë së Kosovës sipas së cilit bizneset dhe sindikatat e punëtorëve të përfaqësohen në KES me më shumë se një organizatë. Oda Ekonomike e Kosovës dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura nuk kanë qenë të gatshme që të lëshojnë vend në KES për organizatat tjera, siç janë Aleanca Kosovare e Bizneseve dhe Konfederatës së Sindikatave të Lira të Kosovës. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Punës, KES ka obligim që të nxjerr kontratën e re kolektive si dhe të përcaktoj pagën minimale. Në rast se nuk tejkalohen dallimet në KES, do të vihet në pikëpyetje edhe zbatimi i Ligjit të Punës.

Edhe pse Qeveria e Kosovës në prill të 2009 kishte miratuar Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale dhe të njëjtin ja kishte dërguar Kuvendit për miratim, Qeveria është përduruar për këtë hap dhe ka kërkuar tërheqjen e tij nga procedurat e mëtutjeshme. Arsye për këtë ishte kostoja e lartë shtesë buxhetore, e cila në rast të miratimit të ligjit të ri do të rëndonte buxhetin e Kosovës me 3.3 milion euro shtesë në vit. Me ndryshimet në ligj parashihej edhe decentralizimi i menaxhimit me ndihmën sociale nga niveli qendror në atë lokal. Këtë transferim të përgjegjësisë Qeveria e ka bërë përmes akteve nënligjore: Udhëzimit Administrativ për procedurat e delegimit të përgjegjësisë për skemën e ndihmave sociale në nivel komunal, i miratuar në mars 2010.

Edhe më tutje numri i përfituesve nga ndihmat sociale ka mbetur i njëjtë. Sipas KASH 2011-2013, 325.000 persona apo 15% e popullsisë kanë qasje në njërën nga skemat e pagesës sociale dhe kjo shifër është paraparë të mbetet e njëjtë edhe për tri vitet në vazhdim. Shkalla e varësisë mbetet e njëjtë me 45%, përdërisa varfëria ekstreme llogaritet në 15%.⁵⁰

Pa debat për koston financiare dhe me konsensus të plotë është miratuar Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre. Ky ligj ka një ngarkesë shtesë buxhetore prej 5.2 milion euro në vit, për tri vitet në vazhdim.⁵¹

Edhe më tutje Kosova nuk ka ligj për sigurime shëndetësore dhe fond për sigurim shëndetësor. Edhe pse në bazë të Strategjisë Legjislative të Qeverisë së Kosovës për 2010 parashihet që të

⁴⁶ Enti i Statistikës së Kosovës. Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2009. Korrik 2010.

⁴⁷ Të dhënat e punësimit, që paguhen nga Buxheti i Kosovës, janë marrë nga Raporti Gjashtë mujor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për 2010, i miratuar në Qeveri më 4 gusht 2010.

⁴⁸ Enti i Statistikës së Kosovës. Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore 2009. Korrik 2010.

⁴⁹ MPMS. Informatat e Tregut të Punës në Kosovë – gusht 2010.

⁵⁰ World Bank. Public Expenditure Review. June 3, 2010.

⁵¹ Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2011-2013, miratuar në Qeveri më 11 qershor 2010 me vendimin 03/128.

miratohej në shkurt të 2010 Projektligji për Sigurime Shëndetësore, kjo nuk ka ndodhur ende. Në përgjithësi, sektori i shëndetësisë në Kosovë mbetet në gjendje jo të mirë. Ministri i Shëndetësisë është zëvendësuar në maj 2010, mirëpo nuk ka asnjë përmirësim të gjendjes në këtë sektor. Ministria e Shëndetësisë gjatë 2010 është karakterizuar më shumë me emërime dhe largime të udhëheqësve në institucionet shëndetësore, siç është rasti me sekretarin e MSH dhe drejtorin e Qendrës Klinike Universitare. Punonjësit shëndetësor sërish kanë kërcënuar me greva, si pasojë e mos realizimit të kërkesave të tyre dhe zbatimin të marrëveshjes të arritur në mes Federatës Sindikale të Shëndetësisë dhe Qeverisë së Kosovës më 14 tetor 2008.

Qeveria ka vazhduar me miratimin e programeve dhe strategjive sociale-shëndetësore. Në dhjetor 2009 është miratuar Plani Strategjik i Kosovës për HIV/AIDS 2009-2013, si dhe Plani i Veprimit për zbatimin e strategjisë së Republikës së Kosovës për integrimin e komuniteteve: Romë, Ashkali, Egjiptian 2009-2015. Në mars 2010 është miratuar Strategjia për Shkollat Promovuese të Shëndetit në Kosovë 2009-2018. Kurse në korrik 2010 është miratuar Plani i Veprimit të Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. Riintegrimi i personave të riatdhesuar ka ngarkuar Buxhetin e Kosovës. Qeveria e Kosovës ka ndarë 500.000 Euro për “Fondin Inicial”⁵² për riatdhesim.

Në përgjithësi, Kosova përballet edhe më tutje me nivelin më të lartë të papunësisë në Evropë. Marrëdhënia e Punës ende nuk është e rregulluar me ligj dhe institucionet zbatuese të ligjeve të punës përballen me pengesa të madha për funksionim. Numri i përfituesve nga skemat sociale ka mbetur i njëjtë. Qeveria ka tërhequr mbrapa Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Skemat e Ndhmës Sociale. Pas kësaj tërheqjeje, bartjen e kompetencave nga niveli qendror në atë lokal sa i përket menaxhimit me ndihmën sociale, Qeveria e ka bërë me anë të një akti nënligjor dhe jo duke miratuar ligj të ri për ndihmat sociale. Qeveria ende nuk ka miratuar Projektligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, si dhe nuk ka miratuar Projektligjin për Sigurimet Shëndetësore. Nuk është bërë asnjë përpjekje në drejtim të ngritjes së fondeve sociale dhe shëndetësore.

⁵² I riemërtuar në “Programin për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar”, që funksionin në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme

5. POLITIKAT SEKTORALE

5.1. Shoqëria civile dhe Media

Shoqëria civile në Kosovë më në fund ka filluar të përjetojë një zhvillim organik të saj, pra zhvillimi i saj vjen si reagim ndaj nevojave të shoqërisë kosovare dhe jo më si reagim ndaj dëshirave dhe synimeve të donatorëve. Shoqëria civile, e organizuar kryesisht rreth organizatave jo-qeveritare, është bërë më e zëshme dhe më aktive dhe ka filluar të luajë rol në profilizimin e opinionit publik në Kosovë. Numri i OJQ-ve të regjistruara mbetet i madh por OJQ-të që janë aktive tërë kohën dhe puna e të cilave vërehet në opinion dhe të cilat edhe kanë ndikim në opinion mbetet shumë i vogël. Disa nga të arriturat e shoqërisë civile në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi, tetor 2009 - tetor 2010: OJQ-të kanë luajtur rol aktiv në monitorimin e zgjedhjeve lokale të nëntorit 2009, kanë vënë nën llupë liderët politikë duke matur “vërtetësinë” e premtimeve dhe zotimeve të tyre dhe kanë ngritur zërin kundër dyshimeve dhe hetimeve për korrupsion dhe abuzim me postet zyrtare në të gjitha nivelet e institucioneve qeverisëse në Kosovë.

Sfida praktike të OJQ-ve në Kosovë mbetet qasja në dokumentet zyrtare e cila shpesh herë ju mohohet ose ju pengohet me zvarritje të kërkesës apo forma tjera të ngjashme nga ana e institucioneve qeverisëse të Kosovës. Sfidë për tërë shoqërinë civile në Kosovë mbetet mobilizimi i shoqërisë kosovare në iniciativat e shoqërisë civile. Ky problem është struktural për shoqërinë e Kosovës dhe me stadin e zhvillimit të shoqërisë, më saktësisht lidhet me mungesën e një klase të mesme në shoqërinë kosovare. Pa individë që kanë një pavarësi financiare e pastaj edhe intelektuale, çfarë paraqet klasa e mesme, është e vështirë për shoqërinë civile të mobilizojë masa të gjëra popullore për iniciativat e veta, sidomos kur në thumb ka qeverinë, që aktualisht është punëdhënësi më i madh në Kosovë.

Mediat në Kosovë kanë bërë hapa prapa në periudhën për të cilën bëhet vlerësimi. Këta hapa prapa vijnë në formë të pengimit të gazetarëve që të kenë qasje në informata por edhe në formë të ndikimit të vet Qeverisë së Kosovës në politikat redaktuese në media, sidomos në RTK, transmetuesin publik të Kosovës apo edhe të kërcënimit fizik të gazetarëve.

Pak kohë pas publikimit të Raportit të Progresit për vitin 2009, EBU (Unioni i Transmetuesve të Evropës) që është edhe themeluese e RTK, i ka dërguar një letër Qeverisë së Kosovës në të cilën Drejtori i Përgjithshëm i EBU-së, Jean Revellion, shpreh keqardhjen e tij që transmetuesi publik i Kosovës është shndërruar nga një burim informimi i balancuar në “dorë të zgjatur” të “partisë në pushtet dhe juve si Kryeministër”.

Në ndërkohë, në këtë periudhë RTK ka arritur që më në fund të kompletohet Bordi i RTK-së dhe të bëjë ndryshime në stafin e vet redaktorial. Megjithatë, një monitorim i punës së RTK-së, i kryer nga KIPRED dhe i publikuar në fillim të tetorit 2010, ka gjetur lëshime të mëdha në programin informativ të RTK-së që vijnë kryesisht për shkak të mungesës së investimeve në aftësimin profesional të stafit të këtij institucioni.

Në të njëjtën periudhë, gazetarët në Kosovë janë ballafaquar edhe me pengesa në punën e tyre si gazetarë, shpesh herë edhe nga zyrtarë të institucioneve të ndryshme. Një ekip gazetarësh i stacionit televiziv Klan Kosova është sulmuar dhe mbyllur në mënyrë të paligjshme në një klasë të shkollës Gjon Sereqi në Ferizaj nga vet drejtori i shkollës, ndërsa një ekip i shtëpisë mediave KOHA është mbyllur në mënyrë të paligjshme në stacionin e policisë në Deçan nga një toger i Policisë së Kosovës. Të dy këto incidente kanë ndodhur në shtator të vitit 2010 dhe janë dënua nga organizatat për mbrojtjen e gazetarëve.

Është vërejtur edhe se gazetarëve të Kosovës u është limituar e drejta për qarkullim të lirë duke u a mohuar marrjen e pasaportave për të udhëtuar, me arsyetimin se janë nën hetime për shkak të punës së tyre. Janë shënua edhe sulme të dhunshme kundër gazetarëve, siç është sulmi me mjet shpërthyes në shtëpinë e kryeredaktorit të Radio Mitrovicës në gjuhën serbe,

Caslav Milisavljevic në Zveçan, më 27 shtator 2010. Hapat prapa në fushën e mediave janë vërejtur edhe nga organizata “Reporterët pa Kufij” që në Indeksin e Lirisë së Shtypit në botë, që botohet çdo vit, në vitin 2010 Kosovën e radhitë në vendin e 92-të, për dallim nga një vit më herët kur Kosova ishte në vendin e 75-të.⁵³

5.2. Sektori i Sigurisë

Konsolidimi i sektorit të sigurisë ka vazhduar edhe gjatë periudhës 2009-2010 mirëpo me hapa të ngadaltë. Pjesa institucionale e legjislacionit është miratuar në pako kryesisht në vitin 2008 mirëpo ende kanë mbetur pa u miratur disa ligje kyçe kurse disa ligje të tjera nuk kanë filluar të implementohen fare. Fjala është për Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku ende nuk është duke u implementuar e veçanarisht nuk është themeluar Agjensioni Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave. Ngjajshëm, Ligji për Klasifikim e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, edhe pse i aprovuar në Kuvend në Qershor 2010 ende nuk ka rezultuar në konsolidimin e Departamentit për verifikimin e sigurisë dhe mbetet sfidë mungesa e kapaciteteve dhe vonesat në këtë aspekt. Ligji për të huajt implementohet pjesërisht dhe është evidentuar shkelje e dispozitave që detyron hyrjen e qytetarëve të huaj në territorin e Kosovës vetëm me pasaportë (përveç nëse është paraparë me marrëveshje të veçantë). Në këtë rast, qytetarët e Serbisë hyjnë në vend vetëm me letërnjoftim edhe pse nuk ka marrëveshje bilaterale. Poashtu, sfidë është aprovimi i një ligji të ri për reagimin emergjent që do të rezultojë në riorganizimin e strukturave të gatishmërisë emergjente. Këshillat Komunale të Sigurisë në Bashkësi janë themeluar në shumicën e komunave mirëpo funksionalizimi dhe performanca e tyre varet nga komuna në komunë dhe se kryesisht pasqyrojnë rezultate të dobëta në performancë.⁵⁴

Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK) ka konsoliduar sekretariatën dhe ka kompletuar infrastrukturën ligjore sekondare. Mirëpo, edhe pse legjislacioni aktual parasheh që të gjitha ligjet në këtë sektor duhet të kalojnë përmes KSK, kjo nuk ndodh dhe që e bënë koordinimin e institucioneve të sigurisë të brishtë. KSK duhet që në strategjinë e ardhshme legjislative të parasheh hartimin dhe aprovimin e Ligjit për Gjendje të Jashtëzakonshme dhe uniformizimin e legjislacionit në lëminë e reagimit emergjent. KSK ka bërë përpjekje për koordinimin e procesit për hartimin e strategjisë së sigurisë së Kosovës.⁵⁵ Edhe pse strategjia është miratuar nga Qeveria e Kosovës në Maj 2010 (dhe pritet të miratohet në Kuvend) drafti është kritikuar që nuk reflekton kontekstin lokal dhe nuk e ka konsideruar pronësinë vendore në hartimin e tij. Vlerësimi i kërcënimeve dhe rreziqeve në strategji nuk adreson realisht sfidat e sigurisë nacionale ndaj vendit gjë që bjen në pikëpyetje implementimin e tij.

Policia e Kosovës (PK) është duke iu nënshtuar një procesi të reformës dhe është evidentuar progres në kohën e fundit. Ka më shumë përpjekje për fuqizimin e konceptit të policimit në komunitet; janë rritur patrollat në këmbë dhe është shtuar efikasiteti i PK. Mbetet shqetësues fakti që nuk është finalizuar drafti i ri i Ligjit për Inspektoriatin e Policisë për shkak të implikimeve.⁵⁶ Që nga vjedhja e të dhënave në Prill 2009, PK ende nuk ka qenë në gjendje që të gjej autorët e këtij rasti. Trajnimet e Policisë vazhdojnë të bëhen në Qendrën e Sigurisë Publike në Vushtrri por nuk ka një avansim akademik të qendrës që vën në pikëpyetje zhvillimin strategjik të PK. Në vazhdimësi raportohet për funksionimin e klaneve brenda PK dhe nuk ka asnjë indikacion për luftimin e këtyre dukurive në polici.

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka bërë progres të kufizuar gjatë periudhës 2009-2010 duke rritur numrin e rekrutëve dhe duke vazhduar trajnimet nën përkujdesjen e KFOR-it. Deri në Gusht të vitit 2010 statistikat tregojnë që janë rekrutuar rreth 2000 pjesëtarë të uniformuar dhe civil⁵⁷ që përbën një pjesë të konsiderueshme të pjesëtarëve të paraparë (2.500 aktiv).

⁵³ Reporters without Borders, <http://en.rsf.org/press-freedom-index-2010.1034.html>

⁵⁴ QKSS, Vlerësimi i Mbiqyrjes Demokratike të Mekanizmave të Qeverisjes së Këshillave Komunale të Sigurisë në Bashkësi, f.3

⁵⁵ Mbledhjet e Këshillit të Sigurisë së Kosovës

⁵⁶ Observimi i QKSS: Roli i agjencioneve të pavarura në mbiqyrjen e sektorit të sigurisë në Kosovë

⁵⁷ Tabela e MFSK-së, 14.08.2010

Pavarësisht këtij numri, FSK nuk i ka arritur kapacitetet operacionale dhe se kapacitetet e tanishme nuk garantojnë ndonjë kontribut substancial të FSK-së në një të ardhme të afërt. Për më shumë, ende nuk kanë filluar trajnimet për përdorimin e armëve të lehta ashtu siç i është besuar me mandat. Nuk vërehet ndonjë gatishmëri serioze e Qeverisë dhe Ministrisë së FSK-së për t'i marr kompetencat gradualisht nga KFOR-i dhe se pronësia vendore në konsolidimin e FSK-së është shumë e limituar. Roli i KFOR-it në konsolidimin e FSK-së mbetet shumë i fuqishëm dhe kjo është demonstruar në raste të ndryshme sidomos në ngrirjen e marrëdhënieve me FSK-në që ndodhi në Mars të 2010 për shkak të pranisë së Gardës së FSK-së në 'Epopenë e UÇK-së'. FSK për vitin 2009 ka pasur një buxhet prej € 21.000.000 mirëpo është shpenzuar vetëm në masë 62% si rezultat i planifikimit të dobët.⁵⁸ Pavarësisht kësaj, është kërkuar rritja për vitin 2010 në 10.000.000 € më shumë.⁵⁹ Sa i përket mbikqyrjes demokratike, në vjeshtë të 2009 është themeluar Komisioni Parlamentar për FSK mirëpo ende nuk është evidentuar ndonjë proaktivitet dhe performancë substanciale nga ana e Komisionit për mbikqyrjen e këtij institucioni.

Agjensioni Kosovar për Inteligjencë (AKI) është në fazën fillestare të konsolidimit dhe së është bërë hapi i parë në rekrutimin e pjestarëve të saj në bazë të një konkursi të hapur në fillim të 2010. Detajet e funksionalizimit të AKI mbeten jo-transparente në bazë të legjislacionit në fuqi sidoqoftë opeacionalizimi i saj pritet të vonojë për shkak të vonesave të Qeverisë në emërimin e Drejtorit dhe më vonë zëvendës drejtorit dhe Inspektorit të Përgjithshëm. Raportet e mediave dhe deklaratat e disa deputetëve kanë potencuar mundësinë e implikimeve të strukturave të ish - Shërbimit Informativ të Kosovës (SHIK) në AKI.⁶⁰ Është konsoliduar komisioni parlamentar për mbikqyrjen e AKI në vjeshtë të 2009. Mbikqyrja demokratike e këtij institucioni mbetet sfidë për vitet e ardhshme.

Kompanitë Private të Sigurisë mbeten një sektor i rregulluar ende në bazë të një rregullore të UNMIK-ut dhe se është bërë përpjekje që nga viti 2007 për hartimin e Ligjit për Sigurinë Private që nuk është miratuar deri në periudhën e raportimit.⁶¹ Qeveria nuk i ka adresuar dobësitë në sektorin privat të sigurisë e sidomos raportimet për shkeljen e të drejtave të punonjësve në këtë industri.⁶²

5.3. Liberalizimi i vizave (kriteret e Strategjisë)

Vizat, menaxhimi i kufirit, strehimi dhe migrimi

Janë bërë hapa përpara sa i përket kornizës legjislative, ku janë miratuar shtatë nga trembëdhjetë udhëzimet administrative për zbatimin e ligjit për të huajt. Udhëzimet administrative të miratuara janë këto: udhëzimi për letërnjoftimin për të huajt, përcaktimi i vulave për hyrje dhe dalje në Kosovë, dokumente udhëtimi për të huajt, dispozitat ndëshkuese të ligjit për të huajt, themelimi i komisioneve për shqyrtim dhe ankesa, përmbajtja, forma dhe metoda e lëshimit dhe e refuzimit të lejes për qarkullim, ndalesa e hyrjes në Republikën e Kosovës.

Nga mesi i vitit 2010, Ministria e Punëve të Jashtme dhe ajo e punëve të brendshme nënshkruan udhëzimin 04/2010 mbi procedurat e dhënies së vizave për të huajt nga shërbimet konsullore të Kosovës. Mirëpo, konsullatat ende nuk janë mirë të pajisura me resurse njerëzore dhe materiale.

Ministria e Punëve të Brendshme e ka kaluar një udhëzim administrativ në fund të vitit 2009 për themelimin e Agjencisë për Regjistrim Civil, që do të përkujdesej për lëshimin e dokumenteve adekuate. Është emëruar drejtori ekzekutiv, por ARC-së i duhet ende kohë ta

⁵⁸ ZAGJ, Raporti i auditimit të pasqyrave financiare të MFSK për vitin 2009, f.8

⁵⁹ Shih Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2010

⁶⁰ E përditshmja 'Koha Ditore' – 22.08.2010

⁶¹ Pas shumë përpjekjeve, Qeveria ka miratuar projekt ligjin në Gusht të 2010 dhe është proceduar tutje në Kuvend

⁶² QKSS, Vlerësimi i Kompanive Private të Sigurisë në Kosovë, f.3

plotësojë të gjithë ekipin e nevojshëm. Në nivel komunal, rreth 75% e librave të regjistrit civil janë digjitalizuar. Është siguruar qasje në internet për mbi 90% të zyrave për regjistrim civil, respektivisht në 231 nga gjithsej 243 zyra. Mirëpo, mbetet të bëhet vlerësimi i secilës prej këtyre zyrave. Për më tepër, ligji për statusin civil nuk është miratuar ende.

Është bërë një përparim i vogël sa i përket kornizës ligjore për menaxhim të integruar dhe kontroll të kufirit dhe çështjeve të tjera lidhur me kufirin. Në nëntor të vitit 2009, shefi i policisë së Kosovës, nënshkroi një udhëzim administrativ mbi detyrat dhe përgjegjësitë e policisë kufitare. Janë finalizuar edhe udhëzimet administrative mbi kontrollin e pikave kufitare dhe mbi incidentet dhe shkeljet në kufi.

Po finalizohen edhe udhëzimet administrative mbi përcaktimin e vijës kufitare dhe ndërtimit të komplekseve në pikat kufitare. Gjithashtu po punohet në gjashtë udhëzime administrative, ku përfshihen edhe udhëzimi administrativ mbi përcaktimin dhe klasifikimin e pikave kufitare; natyra dhe shuma e gjobave për personat fizik dhe juridik të cilët i shkelin dispozitat e ligjit mbi ministrinë e punëve të brendshme dhe ligjit mbi kontrollin e kufijve shtetëror; forma, përmbajtja dhe metoda e vendosjes së shenjave sinjalizuese për vërejtje dhe ato të shkruara në pikat kufitare dhe në hapësirat e kalimit kufitar; lëvizja dhe banimi brenda hapësirave për kalim kufitar; ndalimi, kufizimi ose kushtëzimi i disa aktiviteteve, përgjatë kufijve shtetëror; vendosja dhe përdorimi i pajisjeve teknike për filmim, incizim automatik në zonat për kalim kufitar dhe përgjatë vijës kufitare shtetërore.

Janë bërë përparime edhe në instalimin e një intraneti në të gjitha pikat kufitare ku përfshihen edhe pikat Jarinjë dhe Bërnjak. Gjithashtu, përbrenda doganave dhe policisë kufitare është themeluar edhe IBM qendra e monitorimit të përbashkët, e bazuar në doganat dhe operohet bashkërisht në mes të doganave dhe policisë kufitare. Kjo qendër shërben për monitorimin e pikave kufitare përmes kamerave të vendosura në vetë pikat kufitare e që janë të lidhura me qendrën operative. Mirëpo, kontrolli në pikat 1 dhe 31 mbetet problematik.

Duhet shqyrtuar ligji ekzistues mbi dokumentet personale (pasaportat, letërnjoftimet dhe patentë shoferin) që të mund të adresoj lëshimin e pasaportave biometrike. Janë krijuar grupe për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për dokumentet e udhëtimit, i cili është miratuar nga Qeveria më 26 maj 2010 dhe pritet të hyj në fuqi deri në nëntor 2010.

Ka pasur përparime edhe në fushën e strehimit. Në vitin 2009 është përcaktuar qendra transitore për strehim kërkuesit dhe ekipin menaxhues. Qendra tanimë ka punësuar pesë anëtarë të ekipit, por duhet që të vazhdojë t'i rris kapacitetet e saja. Organe të tjera të rëndësishme të themeluara janë: komisioni kombëtar për refugjatët; komitetit për shqyrtimin e kërkesave për strehim; komisioni përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave të të huajve për qëndrim të përkohshëm, suspendimin dhe anulimin e lejeve të qëndrimit dhe lëshimin e urdhrat për largim; komisioni për shqyrtimin e kërkesave të të huajve për leje qëndrimi të përkohshëm dhe të përhershëm dhe gjithashtu për refuzimin e përhershëm, suspendimin dhe heqjen e lejeve të qëndrimit për të huajt.

Mirëpo, duhet ende shumë punë për pajisjen e këtyre komisioneve me kapacitete njerëzore, forcimin e këtyre kapaciteteve dhe implementimin e politikave për strehim. Me çështjen e migrimit merren dy shtylla institucionale, departamenti për shtetësi, strehim dhe migrim dhe drejtoria për të huaj pranë policisë së Kosovës. Sa i përket migrimit, departamenti për kufij, strehim dhe migrim pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme është ristrukturuar në departamentin për shtetësi, strehim dhe migrim. Gjithashtu zyra për shtetësi është transferuar në departamentin për shtetësi, strehim dhe migrim. Mirëpo, kapacitetet njerëzore që merren me politikën e strehimit dhe migrimit duhen forcuar më tej në mënyrë që këto politika të mund të zbatohen.

Kosova e ka kaluar ligjin mbi ripranimin, që ka definuar kornizën për procedurat e verifikimit dhe kthimin e qytetarëve të Kosovës dhe qytetarëve të huaj që përmes Kosovës kanë kaluar në vendet tjera. Janë nënshkruar marrëveshje bilaterale për ripranim me Shqipërinë, Francën, Maqedoninë, Zvicrën, Gjermaninë, Danimarkën, Norvegjinë dhe Belgjikën. Gjatë periudhës Janar-Mars 2010, numri i të kthyerve shkon në 1198. Gjithashtu është miratuar plani i veprimit për integrimin e personave të kthyer dhe qeveria ka siguruar një shumë prej 500 000 për vitin 2010. Mirëpo ekipi në zyrat për të kthyerit dhe komunitete në nivel komunal duhet trajnuar që të mund të bëhet implementimi i plotë dhe i siguritë i kësaj strategjie.

Pastrimi i parave

Qeveria e ka aprovuar ligjin mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe pritjet edhe miratimi nga parlamenti në korrik të vitit 2010. Ky ligj mundëson themelimin e njësisë së inteligjencës financiare. Në këtë kontekst, me 15 Qershor të 2010 është nënshkruar një memorandum për bartjen e kompetencave të qendrës për inteligjencë financiare nga EULEX-i te ministria e ekonomisë dhe financave. Për ndërtimin e kapaciteteve hulmuese dhe për luftimin e pastrimit të parave, njësitë e inteligjencës regjionale pranë drejtorisë për analizën e krimeve, janë të centralizuara dhe mbahen trajnime të vazhdueshme për ndërtimin e kapaciteteve njerëzore përbrenda shtyllës së hulmtimeve. Gjithashtu, me 1 Qershor të 2010-ës u rekrutuan 24 polic hulmtues në sektorin e hulmtimit të krimeve financiare (departamenti për krime ekonomike dhe financiare dhe korrupsion). Është përgatitur ligji mbi mbrojtjen e dëshmitarit por ende nuk është aprovuar. E njëjta vlen edhe për draft ligjin për ndryshimin dhe përmirësimin e kodit të përkohshëm të procedurës penal në Kosovë.

Narkotikët

Janë bërë hapa para në plotësimin e kapaciteteve njerëzore në planin për luftën kundër narkotikëve. Në mënyrë që të implementohet strategjia dhe plan veprimi kundër narkotikëve, një strukturë e re organizative në shërbimin policor të Kosovës është aprovuar nga policia e Kosovës dhe ministria e punëve të brendshme (Janar 2010), që përfshin edhe themelimin e drejtorisë kundër krimit të përbërë nga tre zyrtar. Është shtuar personeli për luftimin e drogës në doganat e Kosovës, shërbimet korrektuese kanë rritur personelin për luftimin e narkotikëve për shtatë (7) në të gjitha institucionet korrektuese (qendrat për paraburgim dhe burgje) që janë të autorizuar për parandalimin dhe zvogëlimin e kontrabandës ku përfshihen edhe narkotikët. Mirëpo, lidhja me gjyqësorin nuk është realizuar ende për shkak se nuk janë emëruar prokurorët për çështjet e lidhura me narkotikët. Në përgjithësi, dobësia qëndron në kapacitetin e policëve për ta trajtuar në mënyrë efektive trafikimin e narkotikëve dhe niveli i pamjaftueshëm i shkëmbimit të informacionit në mes të institucioneve relevant.

Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit

Sa i përket luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit është bërë shumë pak. Ligji mbi mbrojtjen e dëshmitarit ende nuk është aprovuar, kurse numri i gjyqtarëve që merren me rastet e krimit të organizuar duhet të rritet. Themelimi i agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar mbetet i një rëndësie të veçantë për të mbyllur çarkun në parandalimin e krimit të organizuar. Sfidat tjera mbesin mungesa e kapaciteteve dhe resurseve, bashkëpunimi nga gjyqësori, mungesa e sanksioneve, mungesa e mekanizmave të bashkëpunimit në mes të agjencisë, prokurimit publik dhe EULEX-it. Është paraparë nënshkrimi i një memorandum mirëkuptimi me prokurorinë e Kosovës. Në përgjithësi, organet dhe aktorët relevant në Kosovë vazhdojnë të mos kenë kapacitet ta luftojnë dhe parandalojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Për organizatat që e hartuan Raportin e Progresit *Made in Kosova*

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think Tank i formuar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjajshme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të anvasimit të shoqërisë kosovare.

<http://institutigap.org/>



Instituti Demokratik i Kosovës - KDI

Misioni i KDI është të mbështesë zhvillimin e demokracisë duke fuqizuar qytetarët dhe sektorin joqeveritar për të ndikuar në rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së institucioneve qeveritare dhe përmirësimit të efikasitetit të këtyre institucioneve përmes pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. KDI synon të jetë një organizatë rajonale me ndikim në proceset politike përmes ofrimit të asistencës në procesin e demokratizimit.

<http://kdi-kosova.org/>



Klubi për Politikë të Jashtme - KPJ

Klubi për Politikë të Jashtme është organizatë joqeveritare e cila mbledh rreth vetes intelektualë, politikanë dhe aktivistë të shquar të shoqërisë civile, që tregojnë afinitet në politikë të jashtme. Klubi ka për qëllim që përmes një debati intelektual të kontribuojë përmes rekomandimeve në gjenerimin e politikave të jashtme të Kosovës, në funksion të paqes në Kosovë, rajon dhe botë.

<http://foreignpolicyclub.org/>



Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë - QKSS

QKSS është themeluar me qëllim të bërjes së studimeve, kërkimeve shkencore, organizimit të konferencave dhe tryezave në sferën e politikave të sigurisë në Republikën e Kosovës. Duke pasur parasysh mungesën e institucioneve jo-publike që merren me këte sferë shumë të rëndësishme, QKSS është një zë i fuqishëm në drejtim të studimeve të sferës së sigurisë. Aktivitetet e deritashme të QKSS-së i kanë fuqizuar parimet e mbikqyrjes demokratike të institucioneve të sigurisë në Republikën e Kosovës.

<http://qkss.org/>



Instituti Ballkanik i Politikave - IPOL

Instituti Ballkanik i Politikave është një institut i pavarur dhe jo-fitimprurës që synon të iniciojë dhe thellojë debatin rreth politikave publike në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Me seli në Prishtinë, Kosovë, Instituti Ballkanik i Politikave punon për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë nëpërmjet bërjes së politikave pragmatike që punojnë për të mirën e qytetarëve.

<http://policyinstitute.eu/>



Lëvizja FOL

Organizata është themeluar me qëllim të përparimit të qeverisjes së mirë në Republikën e Kosovës duke kontribuar në rritje të transparencës dhe llogaridhënies, parandalimin e abuzimit me autoritetin publik si dhe për të mbështetur pjesëmarrjen e qytetarëve në procese vendimmarrëse. Konflikti i Interesit, Qasja në Dokumente Zyrtare, Pasuria e Zyrtare të Lartë Publik, Angazhimi Qytetar, Funksionimi i Institucioneve të Pavarura si dhe Kultura e debatit përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.

<http://levizjafol.org/>

